



TEZË MAGJISTRATURE

BASHKËPUNIMI BILATERAL NË MES MAQEDONISË SË VERIUT DHE GJERMANISË NË SFERËN E SIGURIMIT PENSIONAL

Kandidati:
Lulzim Dalipi

Mentori:
Prof. dr. Etem Aziri

Tetovë, 2016

Mentor:

Prof. dr. Etem Aziri

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Komisioni:

Prof. dr. Etem Aziri

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof. dr. Memet Memeti

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof.dr. Agron Rustemi

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

DEKLARATË

Unë Lulzim Dalipi, student në studimet postdiplomike në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi të plotë ligjore dhe morale deklaroj se ky disertacion magjistrature është rezultat i punës sime kërkimore-shkencore me përjashtim të pjesëve që janë të cituara dhe regjistruara në fusnota përkatëse.

Lulzim Dalipi

Abstrakt

Sigurimi social në përgjithësi dhe sigurimi pensional në veçanti, bëjnë pjesë ndër aspektet kyç që mundësojnë funksionalitetin e shoqërive bashkëkohore. Shikuar në aspektin kohorë, sigurimi pensional është një dukuri jo edhe shumë e vjeët, por sot nuk mundet të paramendohet funksionimi i një shoqërije bashkëkohore pa një sistem efikas dhe efektiv të sigurimit pensional.

E drejta e pensionit, pa pikë dyshimi është ndër konceptet bazë që garantojnë një standard të caktuar jetësorë pas përmbylljes së karrierës, respektivishtë pas plakjes së individit. Ndonëse në botë janë ndërtuar sisteme dhe modele të ndryshme të sistemit të sigurimit pensional, mbetet fakti se ato janë në reformim të sipërm, me qëllim të përshtatjes ndaj realiteteve të reja shoqërore dhe ekonomike.

Republika e Maqedonisë së Veriut si një nga vendet që rrjedhuan nga shkapërdrejta e ish federatës jugosllave, ka trashëguar një sistem funksional të sigurimit pensional, por i njëjti ndër vite ka pësuar goditje të shumta që kanë rezultuar edhe me probleme të caktuara të natyrës financiare. Megjithatë, sistemi ka vazhduar të jetë funksional dhe gjatë disa viteve të fundit është modifikuar përmes reformimit dhe inkorporimit të shtyllës së dytë të detyrueshme dhe asaj të tretë vullnetare.

Duke patur parasysh diasporën relativishtë të përhapur si dhe faktin që deri në këtë periudhë një pjesë e mërgimtarëve pas plotësimit të kushteve për pensionim kanë preferuar që të rikthehen në atdhe, Republika e Maqedonisë së Veriut i ka kushtuar një rëndësi të veçantë lidhjes së marrëveshjeve bilaterale me shumë vende të botës në mesin e të cilave edhe me Republikën Federale të Gjermanisë.

Në fakt deri në hyrjen e Marrëveshjes në fuqi në vitin 2005 na fuqi ka qenë Marrëveshja jugosllavo-gjermane e vitit 1956 e cila gjithashtu është pjesë e trajtuar në punim. Por, disertacioni i magistraturës nuk ka për synim thjeshtë të ofrojë një analizë historike të zhvillimit të marrëveshjeve bilaterale në mes dy vendeve, por përkundrazi synon të trajtojë çështjen e efekteve reale të funksionimit të kësaj marrëveshje mbi standardin jetësorë dhe përgjithësishte

mbi sistemin jetësorë të pensionistëve që gëzojnë pension Gjerman. Në suaza të kësaj punimi ofron analizë edhe të sistemit gjerman të sigurimit pensional si sistemi më i vjetër i kësaj natyre në botë.

Fokusi i punimit është mënyra e funksionimit dhe përmbajtja e Marëveshjes bilaterale në mes Maqedonisë dhe Gjermanisë, në pjesën e sigurimit pensional, edhe atë analizuar si nga aspekti formal ashtu edhe nga këndëvështrimi i pensionistëve që sigurojnë të drejtën e transferimit të pensionit të tyre nga Gjermania në Maqedoni në bazë të kësaj marëveshjeje.

Fjalë kyç: sigurim social, sigurim pensional, marëveshje bilaterale, pensionistë

Apstract

Social insurance in general and retirement insurance in particular, are amongst the key aspects that enable the functionality of contemporary societies. Seen from a historic point of view, retirement insurance is not a very old phenomena, although nowadays societies can not be imagined without efficient and effective systems of retirement insurance.

The right to retirement, without a doubt, is one of the basic concepts that guarantee a certain standard of living after the end of a career, respectively after an individual has aged. Although various systems and models of the pension insurance system have been built around the world, the fact remains that they are undergoing reforms in order to adapt to new social and economic realities.

The Republic of Northern Macedonia, as one of the countries deriving from the former Yugoslav federation, has inherited a functioning pension insurance system, but it has suffered numerous blows over the years that have resulted in certain financial problems. However, the system has continued to be operational and has been modified over the last several years through reforming and incorporating the second mandatory and third voluntary pillars.

Given the relatively widespread diaspora and the fact that up to this time a part of the migrants, after fulfilling the retirement conditions, preferred to return home, the Republic of Northern Macedonia attached particular importance to the conclusion of the agreements for bilateral relations with many countries of the world, including the Federal Republic of Germany.

In fact, until the entry into force of the Agreement in 2005, the Yugoslav-German Agreement of 1956, which is also part of the paper, was in force. But the Master's dissertation is not simply intended to provide a historical analysis of the development of bilateral agreements between the two countries, but rather aims to address the issue of the real effects of the operation of this agreement on the standard of living and on the pension system in general, enjoying German pension. This paper provides an analysis of the German pension insurance system as the oldest system of its kind in the world.

The focus of the paper is on the functioning and content of the Bilateral Agreement between Macedonia and Germany on pension insurance, both formally and from the standpoint

of pensioners securing the right to transfer their pension from Germany to Germany.
Macedonia on the basis of this agreement

Key words: social insurance, retirement insurance, bilateral agreement, pensioned citizens

Абстракт

Општо, социјалното осигурување и особено пензиското осигурување се меѓу аспектите што овозможуваат функционирање на современите општества. Во однос на времето, пензиското осигурување не е многу стар феномен, но денес е невозможно да се замисли функционирање на модерното општество без ефикасен и ефикасен систем на пензиско осигурување.

Правото на пензија е несомнено еден од основните концепти што гарантира одреден животен стандард по завршувањето на кариерата, соодветно откако поединецот ќе старее. Иако низ целиот свет се изградени различни системи и модели на системот за пензиско осигурување, останува фактот дека тие се во процес на реформа, за да се прилагодат на новите социјални и економски реалности.

Republika e Maqedonisë së Veriut si një nga vendet që rrjedhuan nga shkapërdrejtja e ish federatës jugosllave, ka trashëguar një sistem funksional të sigurimit pensional, por i njëjti ndër vite ka pësuar goditje të shumta që kanë rezultuar edhe me probleme të caktuara të natyrës financiare. Megjithatë, sistemi ka vazhduar të jetë funksional dhe gjatë disa viteve të fundit është modifikuar përmes reformimit dhe inkorporimit të shtyllës së dytë të detyrueshme dhe asaj të tretë vullnetare.

Република Северна Македонија, како една од државите кои потекнува од поранешната југословенска федерација, наследи функционален систем на пензиско осигурување, но претрпе бројни шокови низ годините што резултираа во одредени финансиски проблеми. Сепак, системот продолжи да функционира и во текот на последните неколку години беше модифициран преку реформа и вградување на задолжителните втор и трет доброволен столб.

Всушност, сè до влегувањето во сила на Договорот во 2005 година, беше во сила југословенско-германската спогодба од 1956 година, што е исто така дел од предметниот договор. Како и да е, магистерската дисертација не е наменета само да обезбеди историска анализа на развојот на билатералните договори меѓу двете земји, туку има за

цел да го реши прашањето за реалните ефекти од работењето на овој договор врз животниот стандард и целокупниот систем на живеење. кои уживаат германска пензија. Овој труд исто така дава анализа на германскиот систем за пензиско осигурување како најстар систем од ваков вид во светот.

Фокусот на трудот е функционирањето и содржината на билатералниот договор меѓу Македонија и Германија од страна на пензиското осигурување, и анализирано формално и со задржување на пензионерите кои го обезбедуваат своето германско трансферно право. Македонија врз основа на овој договор

Клучни зборови: социално осигурување, пенционално осигурување, билатерален договор, пензионери

Përmbajtje e shkurtë

Kreu i: Zhvillimi historik i sigurimit pensional si një e arritur mbarënjëzore

Kreu II: E drejta pensionale në Maqedoninë e Veriut

Kreu III: Bashkëpunimi i Maqedonisë në sferën e sigurimit pensional me Republikën e Gjermanisë

Kreu IV: Qëndrimet e pensionistëve mbi rëndësinë e bashkëpunimit bilateral mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë në sferën e sigurimit pensional

Listë e tabelave

Tab.1.1. Përkufizime alternativë të administrimit social dhe politikave sociale

Tab.1.2. Një analizë e ideologjive politike kryesore në SHBA dhe qëndrimet e tyre ndaj rolit të qeverisë, politikave sociale dhe tregut të lirë

Tab.1.3. Politikat sociale në vendet e Lindjes së Mesme

Tab.1.4. Terminologjia mbi sigurimin pensional

Tab.1.5. Kushte që duhet plotësuar për pensionim në Gjermani

Tab.1.6 Projeksione për zhvillimin e sistemeve pensionale të disa shteteve anëtare të Unionit Evropian sipas analizave të komisionit evropian

Tab.1.7. Sigurimi pensional në disa vende të Unionit Evropian

Listë e figurave

Fig.1.1. Përmbajtja e politikave sociale

Fig.1.2. Klasifikimi i sistemeve të sigurimit pensional

Fig.1.3 Reformat e vitit 2001 në sistemin pensional Gjerman

Fig.1.4. Reformat e vitit 1993 në sistemin pensional Francez

Listë e grafikonëve

Graf.4.1. Gjinia e të anketuarve

Graf.4.2. Struktura moshore e të anketuarve

Graf.4.3. Struktura e të anketuarve sipas komunës

Graf.4.4. Struktura e të anketuarve sipas përvojës në punë

Graf.4.5. Shtyllat e sigurimit pensional Gjerman në mesin e pensionistëve të anketuar

Graf.4.6. Mosha e pensionimit në Gjermani

Graf.4.7. Shkalla e satisfacionit me pensionin

Graf.4.8. Peceptimet e të anketuarve mbi pensionet e tyre

Graf.4.9. Rregullshmëria e pensioneve

Graf.4.10. Informimi i të anketuarve mbi eksistimin e marrëveshjes bilaterale

Graf.4.11. Informimi i të anketuarve mbi përmbajtjen e marrëveshjes bilaterale

Graf.4.12. Informimi i të anketuarve mbi të drejtat dhe obligimet e tyre

Graf.4.13. Përkrahja financiare e pensionistëve për familjarët e tyre

Përmbajtja

Hyrje	15
Lënda e hulumtimit.....	15
Qëllimet e hulumtimit.....	17
Hipotezat.....	18
Metodologjia e hulumtimit	19
Rëndësia e punimit	19

Kreu i: Zhvillimi historik i sigurimit pensional si një e arritur mbarënjerëzore

1.Në përgjithësi mbi politikat sociale	21
2.Sigurimi pensional si një e drejtë e bazuar në punën e kaluar	31
3.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në kontinentin Evropian	37
4.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Mbretërinë e Bashkuar	50
5.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Shtetet e Bashkuara të Amerikës	51

Kreu II: E drejta pensionale në Maqedoninë e Veriut

1.Sigurimi i të drejtës pensionale gjatë periudhes së monizmit.....	54
2.Sigurimi i të drejtës pensionale pas pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut nga ish federata Jugosllave	56
3.Përfitimi i të drejtave të pensioneve në bazë të pleqërisë, invaliditetit dhe asaj familjare	57
4.Arritja, shfrytëzimi si dhe humbja e të drejtës së pensionit.....	62
5.Sigurimi i fondeve, si dhe mënyra a pagesave të pensioneve në Maqedoninë e Veriut	63

Kreu III: Bashkëpunimi i Maqedonisë në sferën e sigurimit pensional me Republikën e Gjermanisë

1.Në përgjithësi mbi bashkëpunimin në sferën e sigurimit pensional.....	67
2.Bashkëpunimi me R. e Gjermanisë para pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut.....	70
3.Nënshkrimi i marrveshjes për bashkëpunim pas pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut.....	71
4.Analiza e rasteve konkrete në sferën e sigurimeve pensionale prej vitit 2003-2019	72

Kreu IV: Qëndrimet e pensionistëve mbi rëndësinë e bashkëpunimit bilateral mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë në sferën e sigurimit pensional

1.Përshkrim i kampionit	79
2.Përshkrim i rezultateve	84
3. Komentim i rezultateve kundrejt hipotezave.....	91
 Përfundime dhe rekomandime	 93
Bibliografia	95
Shtojcë	97

Hyrje

Lënda e hulumtimit

Politikat pensionale ku bën pjesë edhe sigurimi pensional paraqesin pa dyshim sferën më domethënëse të organizimit të shoqërive bashkëkohore. Politikat sociale në përgjithësi, dhe sigurimi pensional si segment kyç i tyre, tanimë një kohë më të gjatë në kontekst global, e sidomos në shtetet e zhvilluara të mirëqenies sociale nënkuptojnë pjesën më aktive të politikave publike të pushtetit. Për dallim nga intervenimet e shtetit modern dhe institucioneve të tij për tejkalim të problemeve të shprehura sociale në shoqëri, sigurimi pensional paraqet një të drejtë specifike që bazohet në punën e kaluar të qytetarëve dhe reflektimin e asah pune në shekullin e jetës së qytetarëve, kur për shkak të moshës aftësija e tyre për punë aktive zvogëlohet në mënyrë të dukshme.

Sot, praktikat e sigurimit pensional, përveç të përbashkëtës nënkuptojnë edhe dallime të caktuara prej shteti në shtet. E drejta e pensionimit si një vlerë e përgjithëhsme sigurohet në bazë të më shumë kriterëve të bazuara në ligjet e shteteve përkatëse, konventave ndërkombëtare, por edhe marrëveshjeve bilaterale në rastet kur qytetarëi shekullin e punës (ose një pjesë të tij) e ka kaluar si i punësuar jashtë shtetit amë. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale siç është ajo në mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë është me një rëndësi të veçantë si për shtetet që i tangon problemi, ashtu edhe për shfrytëzuesit e së drejtës pensionale. Rregullimi i kësaj materie përmes kontratave ndërmjet shteteve tejkalon shumë situata në favor të shfrytëzuesve të drejtës pensionale, sidomos kur ata punësohen jashtë vendit të tyre në bazë të migrimit spontan për shkak të situatave të pavolitëshme sociale në vendet e tyre.

Ashtu siç del nga vetë titulli i propozim-tezës, lëndë e këtij disertacioni të magjistraturës është hulumtimi i sigurimit të drejtës pensionale qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përkohësisht të punësuar në Gjermani. Gjërmania është një nga destinacionet e preferuara ku kanë siguruar ekzistencën një pjesë e madhe e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut, ndër vite dhe decenie. Migrimet e para ekonomike drejt Gjermanisë u shënuan në vitet

e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Edhe pse, në atë kohë u emërtuan si “të punësuar të përkohëshëm”, në botën e jashtme, këto persona u bëne pjesë e përherëshme e shoqërive perëndimore e sidomos të shtetit Gjerman. Sot flitet për gjeneratën e tretë të atyre që dikur kanë konsideruar si të punësuar të përkohëshëm.

Meqë sigurimi pensional dhe e drejta pensionale është e drejtë bazike për këtë kategori të qytetarëve tonë, hulumtimi i kësaj problematike është me një rëndësi të veçantë praktike. Duke u nisur nga qasja standarde metodologjike, për temën e propozuar, me rëndësi të veçantë janë katër segmente që në fakt paraqesin një tërësi integrale: parashtrimi i qartë i problemit të hulumtimit, hipotezat bazë dhe ndihmëse, metodat që do të përdoren so dhe rezultatet e pritura nga hulumtimi.

Duke u nisur nga ajo që u tha më lartë, lënda e hulumtimit do të shtjellohet për analizës së drejtës së sigurimit pensional si një e arritur madhore sociale, humane dhe demokratike, përmes analizave të formave të sigurimit pensional në Maqedoninë e Veriut dhe përmes specifikave të sigurimit pensional në shtetin Gjerman dhe transferin e të drejtave pensionale nga Gjermania në Maqedoninë e Veriut.

Qëllimet e hulumtimit

Synimi parësorë i disertacionit të magjistraturës është ofrimi i një analize të thukhtë teoretikisht të pranueshme dhe praktikisht korrekte rreth sistemit të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut kundrejt atij në Republikën Federale të Gjermanisë, me qëllim të identifikimit të rrethanave në të cilat realizohet bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve, nënkuptohet komfor marëveshjes adekuate të ndërmjetme.

Si qëllime specifike të disertacionit të magjistraturës mundet të veçohen:

- Të ofrohet një analizë ekstenzive e literaturës vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurimit pensional.
- Të ofrohet një analizë ekstenzive e literaturës vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e bashkëpunieve ndërkombëtare në çështjet e sigurimit pensional.

Qëllimet e disertacionit të magjistraturës janë të shumëfishta, por mundet të redukohen me sa vijon:

- Të ofrohen informata të mjaftueshme mbi sigurimin e të drejtës së pensionimi në Gjermani dhe në Maqedoninë e Veriut.
- Të ofrohet një analizë e mirëfilltë kornizën ligjore të shfrytëzimit të drejtës së pensionimit të shtetet që janë lëndë hulumtimi.
- Të ofrohet një analizë e mirëfilltë e të drejtave dhe obligimeve të shfrytëzuesve të drejtës pensionale, të personave që këtë të drejtë e kanë fituar në Gjermani ndërsa e shfrytëzojnë në Maqedoninë e Veriut.
- Të bëhet analizë e qëndrimeve të personave në fjalë lidhur me sigurimin pensional, kornizën e shfrytëzimit të tij, njohuritë mbi vetë marëveshjen bilaterale dhe mënyrën e konsumit të njejtës në Maqedoninë e Veriut.

Hipotezat

Punimi i magjistraturës do të synon testimin e një hipoteze bazë dhe dy hipotezave ndihmëse.

Hipoteza bazë mundet të përcaktohet me sa vijon:

“Sigurimi pensional i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut me punësim të përkohëshëm në Gjermani realizohet komfor standardeve ndërkombëtare dhe marëveshjes së nënshkruar mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë”.

Si hipoteza ndihmëse mund të përcaktohen si vijon:

“Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, përkohësisht të punësuar në Gjermani, janë mirë të informuar për të drejtat dhe obligimet e tyre që sanksionohen me marëveshjen bilaterale në sferën e sigurimit pensional”.

“Transferimi i të drejtave pensionale nga Gjermania në Maqedoninë e Veriut është cilësorë dhe nuk shkaktohen pengesa për qytetarët e Maqedonisë së Veriut”.

“Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, që janë shfrytëzues të pensionit Gjerman, kontribuojnë në përmirësimin e standardit jetësorë në vend përmes ofrimit të përkrahjes financiare për familjarët e tyre”.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë peripilimit të punimit të magjistraturës do të implementohen metodat dhe teknikat bazë për hulumtim shkencorë. Metoda historike do të vjen në shprehje në veçanti në pjesën e parë të disertacionit të magjistraturës ku do të analizohet ideja e sigurimit pensional dhe rrugëtimi i kësaj ideje ndër vite. Metoda krahasuese do të vijë në shprehje në pjesën kur do të flitet për sigurimin e të shtëjtës së pensionit në Gjermani dhe në Maqedoninë e Veriut. Metoda statistikore do të vijë në shprehje në pjesën ku do të bëhet fjalë për numrin e të pensionuarve gjatë deçenies së fundit. Analiza do të vijë në shprehje në rastin e zbulimit të karakteristikave të veçanta dhe të përgjithëshme të sigurimit pensional mes dy shteteve që janë lëndë hulumtimi, ndërsa sinteza me rastin e përgjithësimin teorik-shkencor të rezultateve të hulumtimit. Anketa do të vijë në shprehje me rastin e sigurimit të dhënave përmes pyetësorit që do të realizohet me shfrytëzues të pensioneve nga Gjermania.

Rëndësia e punimit

Disertacioni i magjistraturës në vetë do të mbart si kontribut teorik ashtu edhe praktik. Rëndësia teorike-shkencore e disertacionit të magjistraturës konsiston në faktin se përmes punimit do të ndriçohen shumë segmente të jetës sociale e sidomos aspekte të sigurimit pensional.

Rëndësia praktike e disertacionit të magjistraturës konsiston në faktin se punimi i publikuar do shërbejë si një udhëzues solid shfrytëzuesve të sigurimit pensional, por edhe qytetarëve tjerë të interesuar për këtë sferë të jetës shoqërore.

KREU

1

ZHVILLIMI HISTORIK I SIGURIMIT PENSIONAL SI NJË E ARRITUR MBARËNJERËZORE

- 
1. Në përgjithësi mbi politikat sociale
 2. Sigurimi pensional si një e drejtë e bazuar në punë e kaluar
 3. Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në kontinentin Evropian
 4. Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Mbretërinë e Bashkuar
 5. Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

1.Në përgjithësi mbi politikat sociale

Politikat sociale pa pikë dyshimi paraqesin një ndër problematikat më komplekse në lëminë e shkencave shoqërore në përgjithësi. Kjo, rezulton para së gjithash nga vetë fakti se nocioni politikë sociale është multidimensional për nga natyra dhe përfshin në vehte shumë aspekte duke filluar nga shteti i mirëqenies, përmes punës sociale, punësimit e deri te arsimi dhe siguria publike. Shikuar nga ky aspekt, vështirë është të bëhet fjalë për një politike sociale të përgjithësuar dhe të “izoluar” nga çështje tjera që preokupojnë shoqëritë bashkëkohore. Andaj, ndërtimi, zbatimi dhe zhvillimi i politikave sociale është një preokupim permanent i qeverisësve në mbarë botën pa marrë parasysh natyrën e sistemit politik dhe shoqërorë në përgjithësi. Gjithsesi që në këtë drejtim, shoqëri të caktuara avansojnë dukshëm kundrejt tjerave, falë suksesit në ndërtimin e kapaciteteve reale financiare dhe njerëzore për të krijuar dhe zbatuar politika adekuate sociale. Por, duhet patur parasysh se zhvillimi i politikave sociale është ngushtë i lidhur me zhvillimin e përgjithëshëm ekonomik, me pasurinë kombëtare, kapacitetet shtetëformuese dhe shumëçka tjetër që paraqitet si parakusht për të patur politika sociale adekuate në botën bashkëkohore.

Shqyrtimi i literaturës nxjerr në pah se autorë të ndryshëm njëkohësisht kanë edhe qëndrime të ndryshme mbi atë se çka si nocion duhet të përfshijnë politikat sociale, në mvarësi nga diapazoni i përfshirjes, dimensionit kohorë dhe kështu me rradhë. Por, edhe pranë kësaj në mesin e shumë autorëve të konsultuar vërehet një lloj konsensusi në qëndrimin se politikat sociale janë në kontekstin shkencorë një derivat i asaj që paraqet “administrimi social”, si një koncept më i gjerë por mjaft i ndërthurur me atë të politikave sociale.

Në tabelën vijuese janë të paraqitura qëndrime të më shumë studjuesve mbi administrimin social dhe politikat sociale me qëllim të përfitimit të një pasqyre më të qartë mbi nocionin, rolin dhe rëndësinë e politikave sociale.

Tab.1.1. Përkufizime alternativë të administrimit social dhe politikave sociale

Autori	Përkufizimi
Richard Titmuss	Në kuptimin më të gjerë të fjalës administrimi social ka të bëjë me studimin e shërbimeve sociale, lëndë e të cilave është përmirësimi i kushteve të jetesës së individit në korniza të relacioneve grupore dhe familjare.
Donnison	Shikuar në kuptimin më të ngushtë të fjalës, administrimi social ka të bëjë me studimin e zhvillimit, strukturave dhe praktikave të shërbimeve sociale. Shikuar në kuptimin më të ngushtë të fjalës, ai paraqet një tendencë për të aplikuar shkencat shoqërore në analizën dhe gjetjen e zgjidhjeve për një gamë të gjerë dhe të ndryshueshme të problemeve sociale.
Paul Spicker	Politikat sociale fillojnë me studimin e shërbimeve sociale dhe shtetin e mirëqenies.
Pete Alcock	Politikat sociale kanë të bëjnë me aktivitetin e bërjes së politikave për të promovuar mirëqeniesn si dhe me studimin akademik të aktiviteteve në fjalë.
Nick Manning	Politikat sociale janë të përqendruara në mënyrën e organizimit të mirëqenies sociale me qëllim të plotësimit të nevojave të individëve dhe grupeve, për kujdes shëndetësorë, strehim, ushqim, vëshmbathje dhe kështu me rradhë. Ajo gjithashtu merret edhe me mënyrat se si identifikohen dhe menaxhohen problemet sociale.
Considine	Politikat sociale kanë të bëjnë me aktivitetet permanente të ndërmara nga aktorë të cilët i shfrytëtojnë insitucionet publike për të artikuluar gjërat që ato i vlerësojnë lartë.
Erskine	Politikat sociale kanë të bëjnë me ato aspekte të politikave publike, operacioneve në treg, konsumit personal dhe marrëdhënieve ndërpersonale që kontribuojnë ose largojnë nga mirëqenia e individëve ose grupeve. Politikat sociale i studjojnë kontekstin social, politik, ideologjik dhe institucional në suaya të cilit ndërtohet, shpërndahet dhe konsumohet mirëqenia.

Në fakt, Richard Titmuss konsiderohet të jetë themeluesi i administrimit social dhe politikës sociale si disiplinë shkencore falë një sërë të ligjëratave publike në cilësinë e profesorit në Shkollën e Londrës për Ekonomi. Ai duke bërë fjalë për natyrën e administrimit social, krahas asaj që vërehet nga tabela e mëlartme do të shtojë se administrimi social ka të bëjë me zhvillimin historik të shërbimeve sociale, me vlerat morale në ndërmarrjen e aktiviteteve sociale, me rolin dhe funksionalitetin e shërbimeve sociale, me aspektet ekonomike të tyre si dhe me rolin e tyre në plotësimin e nevojave të caktuara sociale.¹ Ai ka përcaktuar se administrimi social përkatësishtë politikat sociale duhet të merren me çështjet në vijim:²

- Analiza dhe përshkrimi i formulimit të politikave dhe pasojave nga to, qofshin ato pasoja të qëllimëshme ose të paqëllimëshme.
- Analizaë historike dhe komparative e strukturës, funksioneve, organizimit, planifikimit dhe proceseve administrative të institucioneve dhe agjencive.
- Studimi i nevojave dhe problemeve sociale si dhe i qasjes, shfrytëzimit dhe efekteve nga shërbimet, transaksionet dhe transferet.
- Analiza e natyrës, atributëve dhe shpërndarjes së kostove sociale.
- Analiza e shpërndarjes dhe alokimit të kontrollit mbi resueset në aspektin kohorë.
- Analiza e roleve dhe funksioneve në përfaqësuesve të zgjedhur, punonjësve profesionistë, administratorëve dhe grupeve të interesit në menaxhimin dhe sigurimin e performancës së institucioneve të mirëqenies sociale.
- Analiza e të drejtave sociale të qytetarit në cilësinë e kontribuesit, pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit të shërbimeve sociale.
- Analiza e rolit të pushtetit (qendrorë dhe lokal) si një alokues i vlerëve dhe të drejtave mbi pronësinë sociale ashtu siç është paraprë me ligjet dhe rregullativat tjera.

Politikat sociale, për nga natyra përfshijnë më shumë fusha si:³


¹ Richard M. Titmuss: **Essays on "The Welfare State"**, Ruskin House, 1959, 14

² Richard M. Titmuss: **Commitment to Welfare**, Allen and Unwin, 1968, 20-24

³ Paul Spicker: **Social Policy: Theory and Practice, Third edition**, Policy Press, 2014, 4

- Politika dhe praktika administrative në administrimin e shëndetësisë, sigurisë sociale, arsimimit, punësimit, kujdesit për bashkësinë dhe menaxhimi i strehimit.
- Rrethanat në të cilat ka gjasa të vijë deri në rrezikim të mirëqenies së njerëzve duke përfshirë këtu: paaftësinë për të punuar, papunësinë, sëmundjet mendore, paaftësimin intelektual dhe moshën.
- Problemet sociale të tilla si krimet, mvarësitë dhe shkapërdredhja e familjeve.
- Çështje që rezultojnë me disavantazhe sociale të tilla si raca, gjinia dhe varfëria.
- Gama e reagimeve kolektive sociale ndaj rrethanave të mëlartme.

Fig.1.1. Përmbajtja e politikave sociale



Sipas: Pete Alcock: **Social Policy in Britain: Themes and Issues**, Macmillan Press Ltd, 1996

Kur bëhet fjalë për politikat sociale, duhet patur parasysh se ato në praktikë kanë evoluuar paralelishtë me evoluimin e shoqërisë njerëzore. Kështu, në rastin e njërës nga

demokracitë më të zhvilluara të botës, Britanisë së Madhe, në qindvjeçarin e fundit mundet të dallohen disa faza në zhvillimin e politikave sociale:⁴

- Zhvillimi i shoqërisë Fabiane. Bëhet fjalë për një shoqëri të krijuar në vitin 1884 e cila zhvilloi një qasje kritike ndaj problemeve ekonomike dhe sociale që haseshin në Britaninë e Kogës duke kërkuar vendosjen e mbrojtjes sociale si mjet për angazhim të drejtëpërdrejtë të shtetit në luftimin e të njejtave.
- Shteti i mirëqenies dhe konsensusi i mirëqenies. Bëhet fjalë për një sërë të reformave të përgjithëshme sociale që janë ndërmarrë menjëherë pas luftës së dytë botërore me ardhjen në pushtet të Partisë Laburiste si një përfaqësuese e parimeve të shoqërisë fabiane. Reformat në fjalë përfshinin arsimimin pa pagesë deri në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, shërbim mjekësorë pa pagesë me qëllim të luftimit të sëmundjeve, angazhim të shtetit në luftimin e papunësisë, krijimin e banesave publike të dhëna në disponim për tu marrë me qera nga ana e qytetarëve në nevojë, etj.
- Pluralizmi teorik. Fazë kjo që ka filluar nga vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar dhe që u dallua për nga ndryshimi i nocionit “administrimi social” dhe zëvendësi i tij me nocionin “politikat sociale” në vitin 1987.
- Majtizmi i ri. Gjithashtu i zhvilluar në vitet e gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta të shekullit të kaluar e që nisët nga supozimi se me reformat e bëra nuk ka ndryshuar asgjë, por thjeshtë u janë ofruar ca benefite të varfurve dhe klasës punëtore me qëllim të garantimit të parakushteve për zhvillim të mëtejshëm të kapitalizmit përmes sigurimit të një bazë të sigurtë për funksionim të ekonomisë së tregut.
- Djathzimi i ri. i zhvilluar në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, e në veçanti për ardhjes në pushtet të Margaret Thatcher, përfaqësuesit e kësaj qasje e kundërshtonin në mënyrë të drejtëpërdrejtë shtetin e mirëqenies duke

⁴ Pete Alcock: *The Subject of Social Policy*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Eright (Ed): **The Student's Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John Eiley & Sons, Ltd, 2012, 6-9

konsideruar se i njëjti në mënyrë të drejtëpërdrejtë është në kundërshtim me koceptin e ekonomisë së tregut.

- Lëvizjet e reja sociale. Në fundin e shekullit të kaluar gjithnjë e më shumë kanë ardhur në shprehje lëvizje sociale të tilla si ato për mbrojtje nga diskriminimi në baza gjinore, raca, paaftësia e të cilat kanë rezultuar me zgjerim të përfshirjes së politikave sociale edhe në këto çështje.

Politikat sociale janë refleksion i normave dhe vlerave shoqërore. Shumë politika sociale kanë elementin normative, dhe janë të ndërtuara me qëllim të influencimit të shoqërisë ose sjelljes së individëve dhe orientimit të ryre drejt besimeve dhe vlerave të qëndrueshme. Andaj mundet të bëhet fjalë për principe normative majtiste të cilat midis tjerash përfshijnë edhe idenë e barazimit të rezultateve për njerëzit. Nga ana tjetër këndvështrimet konservative synojnë të theksojnë idenë se politikat sociale duhet tu përmbahen “vlerave tradicionale familjare” ose sipas mundësive të shfrytëzojnë maksimalisht sektorin e vullnetarizmit në sigurimin e shërbimeve të mirëqenies, e jo në bazë të zgjerimit të roolit të qeverisë.⁵

Nuk ekziston një gjëndje e mirëqenies Evropiane dhe nuk mundet të dallohet një politikë sociale Evropiane si identitet në vete. Megjithatë, Evropianët politikavë sociale u kushtojnë shumë të tepër rëndësi në krahasim me pjesë tjera të botës. Jo të gjitha vendet e Evropës janë të sukseshme në luftimin e varfërisë ose luftimin e pabarazisë në të ardhura, por edhe pranë kësaj vendet që kryesojnë luftën e fenomeneve në fjalë janë vende Evropiane.⁶

Në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, politikat sociale publike zakonisht konsiderohen si ngarkesë për qytetarët dhe ekonominë e vendit. Për pasojë, ndonëse nuk është e neglizhura lufta me varfërinë ekstreme, përkrahje sociale afrohet në korniza shumë të ngushtuara me atë që nga pranuesit e një përkrahje të tillë pritet që në vazhdimësi aktivisht të kërkojnë punësim, në të kundërtën mundet tu ndërpritet ndihma në fjalë. ShBa-të në masë të madhe dallojnë nga kombet tjera edhe për nga fakti se në këtë vend nuk ekziston një mbrojtje gjenerale shëndetësore. Disa masa të vendosura në fuqi në vitet e gjashtëdhjeta si përkujdesi

⁵ Ken Blakemore, Edëin Griggs: **Social Policy: An Introduction, Third edition**, Open University Press, 2007, 16

⁶ Jochen Clasen: *Social Policy in Europe*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Eright (Ed): **The Student's Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John Eiley & Sons, Ltd, 2012, 432

shëndetësorë për pleqtë (Medicare) dhe ai për shumë të varfurit (Medicaid), ndonëse e lehtësojnë situatën përsëri nuk mundësojnë arritjen e efekteve të duhura në plan nacional.⁷ Megjithatë, në këtë drejtim duhet theksuar se në vitin 2010 me propozim të kryetarit Barack Obama, në vitin 2010 është miratuar Patient Protection and Affordable Care Act (PPACA), si një tendencë për të ofruar një mbrojtje më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes shëndetësore në vend, e që publikishtë u bë i njohur si ObamaCare. Por, në shoqërinë Amerikane ende nuk kanë përfunduar debatet publike rreth asaj se kjo legjislative a ka sjellur përmirësim real për pjesën më të madhe të qytetarëve, para së gjithash falë tendencave të shumta për të ndryshuar dhe hedhur poshtë atë, në veçanti në periudhën pas marrjes së mandatit nga ana e kryetarit aktual të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjithsesi që edhe në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ideologjitë politike luajnë një rol të rëndësishëm edhe kur janë në pyetje politikat sociale në vend., tab.1.2.

Tab.1.2. Një analizë e ideologjive politike kryesore në SHBA dhe qëndrimet e tyre ndaj rolit të qeverisë, politikave sociale dhe tregut të lirë

Ideologjia	Pikëpamjet mbi rolin	Pikëpamjet mbi	Pikëpamjet mbi rolin
------------	----------------------	----------------	----------------------

⁷ Michael Hill: *Social Policy in Liberal Market Societies*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Eright (Ed): **The Student's Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John Eiley & Sons, Ltd, 2012, 435

	e qeverisë	politikat sociale	e tregut të lirë
Konzervatore	Më pak kyçje të qeverisë	-Prezenca e shumë politikave sociale komprometon konceptin e vetëbesimit dhe pamvarësisë si vlerë bazë e të qenit Amerikan -Shek.XX është shekull i teprimit në politika sociale	Ekonomija e tregut për nga natyra gjithmonë do të jetë në shërbim të interesit të Amerikanëve.
Liberale	Kyçje më e lartë e qeverisë	Më shumë politika sociale të bazuara në drejtësi dhe dhëmbëshuri do ta mbrojnë individin	Ekonomia e tregut është mekanizëm për të realizuar rritje dhe për të mbrojtur individët e marginalizuar
Neoliberale	Më pak kyçje të qeverisë	Nuk duhet të mbështetetmi te qeverisa për të tejkaluar problemet sociale, por politikat sociale mundet ta avansojnë të mirën e përgjithëshme	-Kapaciteti i ekonomisë së tregut për të mbrojtur individët e marginalizuar është i diskutueshëm. -Shteti duhet ta kontrollojë ekonominë
Libertariane	Laissez-fare qeveri dhe liri të shprehura	Politikat sociale rezultojnë me kufizim	Qeverija nuk duhet aspak të jetë e kyçur

	qytetare	të parimeve të demokracisë	në çështjet ekonomike
Burimi: Jillian Jimenez, Eyleen majers Pasztor, Ruth M. Chambers, Cheryl Pearlman Fujii: Social Policy and Social Change: Toëard the Creation of Social and Economic Justice, Second edition, SAGE Publishing, 2015, 45			

Kur bëhet fjalë për politikat sociale në Kinë, duhet ptur parasysh dy momente në veçanti. Nga njëra anë vërehet një traditë mjaft e shrehur konfuçiane e qeverisjes, e cila mirëqenien e konsideron si një pçështje që duhet decentralizuar, në ç’rast rolin kyç në këtë drejtim e luan familja e zgjeruar. Trendi tjetër është fshira e qasjes tradicionale nga ana e lëvizjes komuniste nën udhëheqjen e Mao Ce Tungut pas përfundimit të luftës së dytë botërore. Sot në ambientet urbane janë ndëruar politika sociale të avansuara me qëllim të sigurimit të pensioneve dhe mbritjes shëndetësore. Nga ana tjetër në ambientet rurale implementohet një gamë e shërbimeve shëndetësore të subsiduara drejtëpërdrejtë nga ana e shtetit. Megjithatë sistemi ka ende shumë zbrazëtira të paplotësuar.⁸

Në rastin e Lindjes së Mesme, shtetet përkatëse kryesishtë i kushtojnë rëndësinë e duhur politikave sociale dhe janë në fazë të mbindërtimit të njëjtave dhe përshtatjes së tyre me rrethanat reale ekonomike dhe shoqërore, tab.1.3.

Tab.1.3. Politikat sociale në vendet e Lindjes së Mesme			
	Mbrojtje sociale / plotësim i	Mbrojtje sociale /	Programe

⁸ Michael Hill: *Social Policy in Liberal Market Societies*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Ėright (Ed): **The Student’s Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John Ėiley & Sons, Ltd, 2012, 442-443

	nevojave esenciale								ndihmë sociale				për zhvillim		
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Bahreini	X	X		X	X	X	X		X	X					
Egjipti	X	X	X	X	X	X	X	X	X				X	X	
Iraku	X	X		X	X		X			X					X
Jordania	X	X		X	X	X				X					X
Kuvajti	X	X	X	X	X		X		X		X	X			
Libani	X	X	X	X	X	X			X						
Omani	X	X		X	X				X						
Teritoret Palestineze	X	X	X	X	X	X	X			X	X		X	X	X
Katari	X	X		X	X	X			X			X			X
Arabia Saudite	X	X	X	X	X		X		X				X	X	X
Sudani	X	X	X	X	X										X
Siria	X	X		X	X										
Tunisi	X	X	X			X	X	X	X	X			X	X	X
Emiratet e Bashkuara Arabe	X	X		X	X				X	X					
Jemeni	X	X		X	X										X

*1-Rrjete të sigurisë sociale (trasfere të parave, ndihma në ushqime; 2-sigurim social i bazuar në kontribut; 3-kujdes social dhe punë sociale; 4-zgjerim i shërbimeve bazike arsimore, 5-zgjerim i shërbimeve bazike shëndetësore; 6-sigurim shëndetësorë për të gjithë qytetarët; 7- strehim i lirë; 8- mbul i pjesërishëm i shpenzimeve për ushqime; 9- Zeqat dhe fonde sociale, shoqëria civile, bamirësi; 10-trajnime për punësim; 11- cooperative tregtare; 12-edukim qytetare; 13-zhvillim i ndërmarjeve të vogla; 14- zhvillim i punësimit përmes politikave makroekonomike; 15-zhvillim rural.

Burimi: Rana Jaëad: *Social Policy in Middle-Eastern Societies*, **Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Eright (Ed)**: The Student's Companion to Social Policy, Fourth Edition, **John Eiley & Sons, Ltd, 2012, 451**

2.Sigurimi pensional si një e drejtë e bazuar në punën e kaluar

Sigurimi pensional është ndër aspektet më të rëndësishme të sistemit të përgjithëshëm të sigurimit social, sistem ky që është me rëndësi vitale për funksionalitetin e shoqërive bashkëkohore. E drejta e pensionit, si e tillë, mundet të klasifikohet në kategorinë e të drejtave bazë që mundësojnë funksionalitetin e individit dhe në raste të caktuara familjeve bërthamë, pas arritjes së moshës së caktuar. Ndonëse një e drejtë e paraparë gati në çdo cep të botës, qasjet ndaj të drejtës së pensionit në veçanti dhe sigurimit social në përgjithësi, përsëri mundet të veçohen dallime të caktuara nga vendi në vend, në mvarësi nga modeli i përzgjedhur.

Tab.1.4. Terminologjia mbi sigurimin pensional

Nocioni	Përmbajtja
Sistem pensional publik	Sigurim i detyrueshëm publik për moshë të vjetër për tërë popullsinë ose një pjesë të saj (eksistojnë mundësia e eksistimit të më shumë skemave paralele).
Sistem pensional i detyrueshëm	Sistemi pensional publik + pjesë të detyrueshme të skemave pensionale profesionale (sipas vendit të punës) / personale
Sistem pensional	Sistemi pensional publik + pjesë të detyrueshme të skemave pensionale profesionale (sipas vendit të punës) / personale që plotësojnë kritere të caktuara logjore për të qenë të konsideruara si të subsidueshme nga ana e pushtetit përmes lirimeve tatimore ose granteve direkte.
Provision pensional	Sistem pensional + forma tjera të kursimeve dhe sigurimeve + banim në pronësi personale
Të ardhura për moshë të vjetër (të ardhura pensionale)	Të ardhura nga provizione pensionale + përkrahje financiare nga sisteme subsidiare + beneficione tjera sociale + transfere private
Burimi: Birgit Mattil: Pension Systems: Sustainability and Distributional Effects in Germany and the United Kingdom, Physica Verlag, 2006,8	

Në makro-nivel sistemi pensional përkujdeset për një shpërndarje simultane të fondeve midis gjeneratave të vjetra dhe gjeneratave të reja në çdo periudhë kohore. Vetë mekanizmi i shpërndarjes mvaret nga metoda e aplikuar e financimit: pagesa në proces, e financuar ose kombinimi midis tyre. Në sistemin e pagesës në proces, pensionet paguhen nga të ardhurat e popullsisë së punësuar, ndërsa në modelin e sistemit të financuar pensionet sigurohen nga asetet e akumuluar. Në mikro-nivel sistemi pensional realizon një shpërndarje sekuenciale të fondeve gjatë periudhës aktive dhe post-aktive të jetës së individit. Mekanizmi i shpërndarjes a të bëjë vetëm me rastin e modelit të financuar.⁹

Në dizejnimin dhe analizën e sistemeve të sigurimit pensional duhet kushtuar rëndësi e veçantë tre parimeve bazë:¹⁰

- Drejtësia brenda gjeneratës. Një nga funksionet bazë të sistemeve pensionale është është që individët të kenë të ardhura të përfuqta në të gjitha fazat jetësore duke i detyruar ato të kontribuojnë në skemat e sigurimit pensional.
- Drejtësia në mes gjeneratave. Bëhet fjalë për një koncept relativisht të ri dhe vështirë të analizueshëm që nënkupton përkujdesje që secila gjeneratë e ardhëshme të mundet vetes ti mundësojë jetesë më cilësore në krahasim me gjeneratën paraprake.
- Qëndrueshmëria. Në kontekst të sistemeve pensional, në kuptimin më të ngushtë qëndrueshmëria ka të bëjë me atë se sistemi pensional a do mundet të mbahet dhe të zbatohet edhe në të ardhmen (qëndrueshmëria financiare), ndërsa në kuptimin më të gjerë të fjalës ka të bëjë me atë se deri në ç'masë gjeneratat e ardhëshme sistemin pensional do ta konsiderojnë si të drejtë dhe të vlefshëm dhe do të pranojnë të participojnë në te (qëndrueshmëria politike).

⁹ J.B. Kune: *"Solidarities in Collective Pension Schemes"*, Onno Steenbeek (Ed), Fieke van der Lecq: **Costs and benefits of Collective Pension Systems**, Springer, 2007, 16

¹⁰ Për më gjerësishtë rreth parimeve në fjalë konsulto Birgit Mattil: **Pension Systems: Sustainability and Distributional Effects in Germany and the United Kingdom**, Physica Verlag, 2006, 10-17

Krahas kësaj, kur bëhet fjalë për të drejtën e sigurimit pensional duhet patur parasysh disa aspekte bazë:¹¹

- Privatizimi. Privatizimi nënkupton zëvendimin e sistemeve publike të sigurimit pensional me sisteme të sigurimit pensional në menaxhim privat.
- Parafinansimi. Parafinancimi nënkupton akumulimin e mjeteve kundrejt pagesave pensionale në të ardhmen.
- Diversifikimi. Diversifikimi nënkupton lejimin e investimeve në më shumë lloje të asetëve e jo vetëm në bono thesari.
- Benefite të përcaktuara, kundrejt kontributeve të përcaktuara. Planet e definuara të beneficioneve rezultojnë me risqe akruale për kontribuesin; të kushtëzuara nga historiku i të ardhurave të punëtorit, benefitet e pensionimit në shikim të parë janë të determinuara, ndonëse mundet të mvaren nga faktorë të tjerë që mundet të ndikojnë në historikun e të ardhurave, siç është rritja e produktivitetit. Nga ana tjetër, palnet e definuara të kontributeve, bëjnë transferimin e riskut akrual te punëtori individual; madje edhe të kushtëzuara nga historiku i të ardhurave, beneficionet e pensionimit mvaren nga efienca në menxhimin financiar të kontributeve përkatëse.

Rëndësia e sistemeve të sigurimit pensional në veçanti vjen në shprehje duke patur parasysh se:¹²

- Ato zakonisht janë programet më të mëdha të transfereve publike, dhe sit ë tilla shkaktojnë presione të mëdha fiskale (nganjëherë edhe mundësi të reja);
- Ato i influencojnë tregjet financiare përmes krijimit të fondeve të akumuluar dhe përcaktimit të shkallës së kursimeve personale;
- Ato bëjnë regullimin e tregjeve të punës përmes sigurimit të tranzitimi na punësimi drejt papunësisë;

¹¹ Peter R. Orszag, Joseph Stiglitz: *"Rethinking Pension Reform: 10 Myths About Social Security Systems"*, Robert Holzmann (Ed), Joseph E. Stiglitz (Ed): **Neë Ideas About Old Age Security: Toëard Sustainable Pension Systems in the XXI Century**, The International Bank for Reconstruction and Development/ëorld bank, 2001, 9.

¹² Camila Arza, Martin Kohli: *"The Political Economy of Pension Reform"*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008, 2


- Ato u ndihmojnë punëdhënsve në menaxhimin e fuqisë punëtore të tyre përmes ofrimit të instrumenteve për lëvizje ose zëvendësim të punëtorëve;
- Ato ndihmojnë institucionalizimin e një drejtimi general jetësorë përmes krijimit të të sekuenca të parashikueshme kohore midis punës dhe pensionimit;
- Ato punëtorëve ju ofrojnë të drejtën e kërkave legjitime për kompenzim për punën e bërë gjatë viteve aktive, andaj ndikojnë në moralin e shoqërive punuese;
- Ato prodhojnë trende të reja sociale dhe politike përmes krijimit të grupeve të gjera të përfituesve aktual dhe potencial;
- Ato bëjnë strukturimin e agjendës së konfliktëve korporatiste dhe negociatave;
- Ato ofrojnë mundësi për punë dhe zyra administrative;
- Ato ndikojnë në rezultatet zgjedhore.

Një nga qasjet më të zakonshme është klasifikimi i sistemeve pensionale në tre kategori bazë edhe atë: sisteme plotësisht të financuara, sisteme jo të financuara dhe sisteme të kombinuara. Në rastin e sistemeve të financuara pensionale, sistemi pensional secilit anëtarë i paguan anuitete nga llogaria në të cilën ai ka akumuluar mjete gjatë periudhës kur ka qenë i punësuar. Në këtë kategori të sistemeve pensionale numërohen tre sisteme bazë, edhe atë: sistemet e menaxhuara nga ana e pushtetit qendrorë, sistemet pensionale në bazë të profesioneve, e të cilat janë të menaxhuara nga ana e bizneseve private dhe dhe planet personale të kursimit të cilat janë të menaxhuara nga fondet private pensionale. Në rastin e fondeve pensionale të pafinancuara, gjeneratat aktualisht të punësuar bëjnë pagesën e pensioneve të gjeneratave të pensionuara. Në këtë kategori të sistemeve të sigurimit pensional mundet të numërohen: sistemi i rrafsh të beneficioneve, sistemeve i shkallëve të rrafsh, sistemet proporcionale, sistemet e lidhjeve regresionale dhe metodat e indeksimit. Në rastin e sistemeve të benefiteve të rrafsh, niveli i pensionit nuk mvaret aspak nga niveli i kontributeve, me kusht që pensionisti të plotësojë kushtet e kërkuara në kontekst të posedimit të nënshtetësisë për një periudhë të caktuar kohore. Shtetet Skandinave dhe Holanda karakterizohen me këtë sistem të sigurimi pensional. Në rastin e sistemit të shkallës së rrafsh, që është karakteristik për Britaninë e Madhe, pensioni nuk përcaktohet në bazë të kontributit të dhënë, por ndikohet nga periudha kohore në të cilën pensionisti ka qenë i punësuar,

përkatësishtë ka kontribuar financiarishtë. Në sistemet proporcionale, siç është rasti me Gjermaninë, niveli i pensionit është proporcional me kontributin e dhënë gjatë kohës së punësimit. Sistemi regresional, që është specifik për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është një sistem sipas së cilit beneficionet përcaktohen në bazë të një pjesë të kontributit të dhënë e jo në bazë të tërë kontributit të dhënë gjatë periudhës kur individi ka qenë i punësuar. Por, në praktikë në të shumtën e rasteve sistemet e përzgjedhura janë sisteme mikse që përfshijnë si elemente të sistemeve të financuara ashtu edhe elemente të sistemeve të pafinancuara. Në fakt këto sisteme zakonishtë përmbajnë tre shtylla bazë edhe atë: shtylla e sistemit publik të pafinancuar, shtylla e sistemit të detyrueshëm privat (e financiar) dhe shtylla vullnetare private (e financiar).¹³

¹³ Më gjerësishtë rreth këtij klasifikimi konsulto: Andras Simonovits: **Modeling Pension Systems**, Palgrave Macmillan, 2003, 21-55

Fig.1.2. Klasifikimi i sistemeve të sigurimit pensional



3.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në kontinentin Evropian

Kur bëhet fjalë për sistemet e sigurimit social në përgjithësi dhe sistemet e sigurimit pensional në veçanti në kontinentin Evropian dhe në botë përgjithësishtë, prin Gjermania. Në fakt, sistemi i parë i sigurimit pensional në Gjermani është instaluar në vitin 1889 nga ana e Bizmarkut. Gjithashtu duhet theksuar se sistemi Gjerman i sigurimit pensional në masë të madhe ka ndikuar edhe sistemet e sigurimit pensional në pjesë të ndryshme të botës, në veçanti duke patur parasysh faktin se edhe sot ai konsiderohet të jetë ndër sistemet më të drejta në suaza botërore, sistem ky që ndonëse disa herë i modifikuar ka arritur të mbijetojë për më shumë se një shekull.

Në këtë drejtim, duhet theksuar fakti se që nga fundi i shekullit të kaluar gati të gjitha vendet Evropiane, në mvarësi nga rrethanata dhe kapacitetet reale interne i janë qasur modifikimit dhe reformimit të sistemeve të tyre pensionale, komfor realiteteve të reja demografike nga njëra anë dhe nevojës për të garantuar funksionalitetin afatgjatë të sistemit nga ana tjetër.

Debatet intensive politike në drejtim të modifikimit të pensioneve në kontinentin Evropian kanë qenë të përqendruara në katër çështje bazike: realizueshmëria financiare (disbalancet financiare të programeve të sigurimit social janë ndër sfidat kryesore që i kanë detyruar politikë-bërësit të bëjnë shkurtimin e kornizave sociale dhe të bëjnë zmadhimin e kontributeve); konkurrueshmëria ekonomike (problemet financiare kanë qenë të ndërlidhura me vështirë gjenerale ekonomike, përfshirë këtu një nivel të ulët të rritjes vjetore dhe nivele relativisht të ulta të punësimit, në çka kanë ndikuar edhe familializmi katolik dhe rigjediteti i tregjeve të punës); ekuiteti (këto probleme rezultojnë si nga shpërndarja e pabarabartë e mbrojtjes dhe kostove midis grupeve sociale dhe atyre profesionale, ashtu edhe nga dallimet në financimin e resurseve në mes programeve të ndryshme sociale); dhe efektiviteti (një pjesë e dilemave me të cilat ballafaqohen politikë-bërësit është mënyra e riorganizimit të programeve

të mirëqenies me qëllim të zvogëlimit të disbalanceve duke u mundësuar njëkohësisht e mbulimi i risqever përkatëse).¹⁴

Kur bëhet fjalë për sigurimin pensional, një tregues mjaft i mirë në këtë drejtim është Global Retirement Index, sipas së cilit dhjetë shtetet më të avansuara në këtë drejtim në vitin 2018 kanë qenë:

- Zvicra,
- Islanda;
- Norvegjia;
- Suedia;
- Zelanda e Re;
- Australia;
- Irlanda;
- Danimarka;
- Kanadaja;
- Holanda.

Pra, siç mundet të vërehet shtetet Evropiane janë ato që dominojnë përbërjen e listës në fjalë që është një tregues shtesë për rëndësinë e posaçme që këto vende ia japin sistemit të sigurimit pensional. Megjithatë, kur bëhet fjalë për vendet e ndryshme të kontinentin Evropian, duhet patur parasysh që ato kanë kaluar evolucione të caktuara që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, në drejtim të gjetjes së një modeli që do të mundësojë funksionim më efikas të sigurimit pensional, gjithsesi duke patur parasysh edhe historikun, specifikat e funksionalitetit të shoqërisë përkatëse.

Siç u theksua më lartë, Gjermania konsiderohet me një nga sistemet më të vjetra të sigurimit pensional në suaza botërore, falë sistemit të Bizmarkut për sigurime pensione që është vendosur për her të parë në Gjermani nga fundi i shek. XIX. Megjithatë, edhe Gjermania, ngjashëm me shumë ekonomi nacionale Evropiane, e ballafaqur me rrënie permanente të

¹⁴ David Natali, Martin Rhodes: *"The New Politics of Pension Reforms in Continental Europe"*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008, 24

shkallës së shtimit natyror të popullsisë që nga decenie e fundit e shekullit të kaluar ka qenë e detyruar të gjejë modalitete për ta bërë sistemin e sigurimit pensional të saj më të përafart me realitetin e ri ekonomik dhe social në vend.

Për dallim nga vendet tjera si Mbretëria e Bashkuar dhe Holanda, të cilat kanë adoptuar sistemin Beveridgin të sigurimit social e i cili garanton vetëm pensionin bazë, në rastin e Gjermanisë pensionet publike që nga fillimi kanë qenë të dizajnuara asisoj që individit edhe pas pensionimit të mundet të ketë të njejtin standard jetësorë që ka patur edhe gjatë periudhës kur ka qenë aktivishtë i punësuar. Andaj, përgjithësishtë marrë, pensionet publike janë proporcionale me të ardhurat e punës të mesatarizuara për tërë jetëgjatësinë dhe përbajnë vetëm disa veçro redistributive. Për këtë arsye sistemi pensional i Gjermanisë emërtohet si “sigurim pensional” për dallim nga rasti i SHBA-ve ku është i emërtuar si “sigurim social”. Ky karakter i sistemit është edhe më shumë i përforcuar falë ndarjes institucionale: sistemi gjerman i sigurimit pensional nuk është pjesë e buxhetit shtetërorë, përkundrazi ai është entitet i veçantë. Por, ky entitet është i sibsiduar nga qeverija federale.¹⁵

Gjermania, si një nga ekonomitë më të mëdha Evropiane dhe botërore në përgjithësi, gjithaashtu karakterizohet me ndryshime përkatësishtë reformime të shumta të sistemit pensional. Kështu, ndër reformat më të dalluara të këtj sistemi janë ato të vitit 2001 e që u bënë të njohura si reformat e Riesterit, sipas Ëalter Rister, reforma këto që kishin tre qëllime bazë:¹⁶


- Norma të qëndrueshme të kontribuimit me qëllim të limitimit të rritjes së mëtejme të kostove të punës si dhe me qëllim të realizimit të një shkalle më të lartë të barazisë në mes gjeneratave.
- Garantim i stabilitetit afatgjatë të niveleve të pensioneve.
- Zgjerim i kursimeve në bazë të pensioneve private shtesë:

¹⁵ Axel H. Borsch-Supan, Christina B. Eilke: **The German Public Pensions System: Hoë it Ëas, Hoë it ëill be**, Michigan Retirement Research Center, 2003,3

¹⁶ Më gjerësishtë rreth kësaj konsulto: Klaus Stieffermann: *“The never-ending story of German pension reform”*, IPE, 2004

- Subsidium qoftës përmes dallimeve në taksa ose lirimeve tatimore ose sipas nevojës edhe përmes subsidiumit të drejtëpërdrejtë të planeve të caktuara pensionale;
- E drejta e punëtorit individual për të kërkuar plan të veçantë të kompensimit;
- Pensionet profesionale si bazë e negociatave.
- Vendosje e fondeve private pensionale etj.

Fig.1.3 Reformat e vitit 2001 në sistemin pensional Gjerman



Burimi: David Natali, Martin Rhodes: *"The New Politics of Pension Reforms in Continental Europe"*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008, 35

Sot sistemi pensional në Gjermani është i bazuar në tre shtylla edhe atë shtyllën e parë është shtylla obligative, shtylla e dytë që përfshin pensionet sipas profesioneve dhe shtylla e tretë që përfshin sistemin pensional privat. Dy shtyllat e fundit nuk janë të detyrueshme.

Shtylla e parë e pensionit nuk përcakton një pension minimal dhe përfshin pensionimet në bazë të modhës, pensionet për mbijetesë dhe për të paaftët për punë si dhe ofron beneficione lehtësuese.

Tab.1.5. Kushte që duhet plotësuar për pensionim në Gjermani								
		2016	2020	2030	2040	2050	2060	2070
Kushte për tu kualifikuar për pension të plotë	Periudha minimale e kontribuimit për meshkujt (në vite)	5	5	5	5	5	5	5
	Mosha minimale e pensionimit për meshkujt (në vite)	63/2	63/8	65	65	65	65	65
Kushte për kualifikim për pensionim, por pa pension të plotë	Periudha minimale e kontribuimit për femrat (në vite)	5	5	5	5	5	5	5
	Mosha minimale e pensionimit për femrat (në vite)	63/2	63/8	65	65	65	65	65
	Mosha normale e pensionimit për meshkujt	65/5	65/8	67	67	67	67	67
	Mosha normale e pensionimit për femrat	65/5	65/8	67	67	67	67	67
Kushte për kualifikim për pensionim, por pa pension të plotë	Mosha e pensionimit të hershëm për meshkujt	63	63	63	63	63	63	63
	Mosha e pensionimit të hershëm për femrat	63	63	63	63	63	63	63
	Penalti për shkak të pensionit të mëhershëm (në përqind)	-8.7	-9.6	-13.8	-14.4	-14.4	-14.4	-14.4
	Bonus në kusht të pensionimit të vonuar (në muaj)	+0.5	+0.5	+0.5	+0.5	+0.5	+0.5	+0.5
	Periudha minimale e kontribuimit	35	35	35	35	35	35	35

për meshkuj (në vite)							
Periudha minimale e kontribuimit	35	35	35	35	35	35	35
për femrat (në vite)							
Burimi: Axel H. Borsch-Supan, Christina B. Eilke: The German Public Pensions System: Hoë it Eas, Hoë it ëill be, Michigan Retirement Research Center, 2003,3							

Franca në vazhdimësi është karakterizuar me një nga sistemet më komplekse të sigurimit pensional meqë kanë funksionuar skema të ndryshme të sigurimit pensional në mvarësi nga kategoria e punëtorit. Ky shtet ka kaluar një proces mjaft të dhimbshëm të reformimit të sistemit të sigurimit pensional, me atë që impektin më të madh e kanë dhënë reformat e vitit 1993 dhe ajo e vitit 2003. Kështu, p.sh. në sekton privat, të cilit i përkasin pjesa dërmuese e të punësuarve në Francë, sistemi i sigutimit pensional është ndërtuar në bazë të dy shtyllave kryesore, edhe atë: pensionit në bazë të sigurimit social (Caisse nationale d'assurance vieillesse-CNAV) s dhe një vargu të skemave shtesë komplementare të cilat janë të detyrueshme por mvaren nga statusi i punësimit.

Para reformave të vitit 1993, mosha minimale e pensionimit të rregullt ka qenë e fuksuar në atë 60 vjeçare, por me pension të zvogëluar si dhe mosha e pensionimit të rregullt e fiksuar në atë 65 vjeçare (ose 37.5 vjet përvojë pune) në çrast personi i pensionuar ka gazuar të drejtën e 50% të pagës mesatare të realizuar në dhjetëvjeçarin ku paga e tij ka qenë më e lartë.


Reforma e realizuar në vitin 1993 ka nënkuptuar tre ndryshime bazë:¹⁷

- E para, është bërë zgjerim i bazamentit për kalkulim të lartësisë së pagës, edhe atë nga dhjetëvjeçari më i mirë në 25 vjeçarin më të mirë, e që praktikisht në të shumtën e rasteve ka nënkuptuar ulje të pagës mesatare në bazë të cilës është kalkuluar pensioni dhe sipas kësaj edhe rrënie të ardhurave pensionale.

¹⁷ Më gjerësishtë rreth kësaj konsulto: Antoine Bozio: "Impact Evaluation of the 1993 French pension reform in retirement age", **Pensions: An International Journal**, Volume 13, Issue 4, 207-212

- Përfshirje ligjore e indeksimit të çmimeve e që gjithashtu ka rezultuar me zvogëlim të benefiteve në rastet kur rritja e pagave është më e lartë se inflacioni.
- Ofrimi i motivimit për vonim të pensionimit përmes rritjes së minimumit të kërkuar të përvojës së punës nga 37.5 në 40 vite përvojë pune.

Fig.1.4. Reformat e vitit 1993 në sistemin pensional Francez



Burimi: David Natali, Martin Rhodes: *"The New Politics of Pension Reforms in Continental Europe"*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008, 32

Sërish në vitin 2013 janë inkorporuar midifikime përkatëse në sistemin e sigurimit pensional në Francë, edhe atë:¹⁸

- Barazim i kohëzgjatjes së periudhës së kontribuimit, si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik (49 vjet në vitin 2003 për të realizuar pension të plotë).
- Përshtatje e periudhës së kontribuimit me atë të pritjeve për jetëgjatësinë: periudha e punës duhet të jetë së paku dyfish më e lartë se periudha e pritur e pensionimit.
- Vendosje e një shkalle më të lartë të fleksibilitetit kur bëhet fjalë për deduksionet dhe bonuset komform kohëzgjatjes së kontributeve me neutralitet aktual. Secili person i modhës mbi 60 vjeçare gëzon të drejtën e pensionimit, me atë që nëqoftëse nuk ka të realizuara 40 vjet përvojë pune për çdo vit nën këtë prag humb nga 5% të lartësisë së pensionit. Nga ana tjetër për çdo vit përvojë pune mbi pragun 40 vjeçar personi përfiton 3% shtesë në lartësinë e pensionit të tij.

Sistemi i sigurimit pensional në Francë ka pësuar ndryshime të rëndësishme edhe të vitin 2010. Komfor reformave në fjalë është vendosur që:¹⁹

- Duke filluar nga gjenerata e personave të lindur në vitin 1951, bëhet zmadhim gradual i modhës së pensionimit deri në 62 vjeçare ndërsa për personat e modhës 67 vjeçare nuk vlejnë dispozitat për zvogëlim të pensionimit.
- Ofrohet mundësija për pensionim të mëherëshëm për personat që kanë filluar me punë para se të mbushin 18 vjet.
- Prindërit që kanë tre ose më shumë fëmijë e të cilët janë pjesë e ndonjëres nga skemat e shërbimit publik në vend nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohëshëm.

¹⁸ Më gjerësisht rreth kësaj konsulto: Francois Jeger, Michele Lelievre: *"The French pension system and 2003 reform"*, **The Japanese Journal of Social Security Policy**, Vol.4, No.2, 76-84

¹⁹ Më gjerësisht rreth kësaj konsulto: Cindy Duc, Henri Martin, Julie Treguier: **The pension reforms from 2010 to 2015 in France: A detailed analysis of the impact for policyholders and for pension schemes**, Sommaire: Les Dossiers De La Drees, December, 2016, No.9

Sot, sistemi pensional në Francë është i bazuar edhe më tutje në komponentën e skemës bazike dhe atë të skemave shtesë të obligueshme komplementare, kur bëhet fjalë për të punësuarit në sektorin privat në vend. Kështu, të punësuarit në Francë pensionohen në moshë 62 vjeçare me atë që gëzojnë të drejtën të vazhdojnë angazhimin deri në moshë 67 vjeçare, duke realizuar kështu edhe pensione më të larta. Gjithashtu është i mundur edhe pensionimi i parakohëshëm në bazë të papftësisë së punës ose kariereës së zgjatur komform reformave të mëlartme.

Holanda karakterizohet më një nga sistemet më të vjetra të sigurimit pensional në suaza botërore. Kështu që nga viti 1919, ndonëse të drejtat e pensionimit ishin para së gjithash të mvarura nga niveli i kontributeve, përsëri në rast që të ardhurat e personave të moshës 65 vjeçare të jenë shumë të ulta u ka takuar edhe një e ardhur shtesë e financuar nga ana e buxhetit shtetërorë. Në vitin 1956 në Holandë është vendosur një skemë publike e sigurimit pensional sipas modelit të sigurimit pensional të pafinancuar, sistem ky që ka mundësuar rritje permanente të pensionave në këtë vend.

Sot, komform sistemit Holandez që të gjithë qytetarët e moshës 65 vjeçare kanë të drejtën e pensionit nga sigurimi pensional publik, pa marrë parasysh se sa ato kanë kontribuar në periudhën kur kanë qenë të punësuar, madje edhe në rastet kur aspak nuk kanë qenë të punësuar në jetë. Të gjithë të punësuarit janë të detyruar të kontribuojnë në këtë shtyllë të sigurimit pensional, me atë që pensionimi i parakohëshëm nuk është i lejuar. Çështje e vërteta, kjo kategori e të ardhurave nuk është e lartë e shprehur në vlerë absolute, por Holanda ka edhe shtyllën e dytë dhe shtyllën e tretë të sigurimit pensional. Shtylla e dytë është ajo sipas profesionave (sipas vendit të punës), shtyllë kjo që është e detyrueshme me ligj, por aspektet tjera përcaktohen në negociata të ndërmjetme midis organizatës së biznesit nga njëra anë dhe sindikatës së punëtorëve nga ana tjetër. Kësaj shtylle i ushtohet një rëndësi e veçantë, me vetë faktin se ajo duhet të jetë e ndarë nga organizata amë si në aspektin financiar ashtu edhe në atë menaxherial. Për dallim nga të ardhurat pensionale në bazë të shtyllës së parë, të ardhurat nga shtylla e dytë në mënyrë të drejtëpërdrejtë mvaren nga noveli i ta ardhurave, përkatësisht kontributi i dhënë gjatë karrierës personale.

Edhe Zvizra zbaton modelin e tre shtyllave të sigurimit pensional, e që në rastin e Zvicrës është implementuar që nga viti 1972 në bazë të rezultateve të Referendumit të mbajtur për këtë çështje. Megjithatë modeli Zveçeran i sigurimit pensional është mjaft kompleks, me atë që edhe njësitë e ndryshme federative kanë specifikat e tyre. Ajo që është e qartë është se edhe në Zvicër ekziston shtylla e parë e sigurimit pensional përkatësisht baza e parë për sigurimit të drejtës së pensionit me atë që benefiti i siguruar mvaret nga kontributi i dhënë ndër vite. Specifike për këtë shtet është që nuk është e definuar një peeiudhë e kontribuimit. Përkundrazi, konsiderohet se ciklin e kontribuimit e kanë përmbyllur të gjithë individët që kanë kontribuar për aq vite sa kanë kontribuar shumica e të tjerëve që kanë lindur në po të njëjtin vit. Pra, nëqoftëse personi e ka të përmbyllur ciklin e kontribuimit, në atë rast gëzon të drejtën e pensionit të plotë, ndërsa në të kundërtën merr vetëm pension të pjesërishtë. Mosha e përgjithëshme e pensionimit është ajo 65 vjeçare për meshkujt dhe 64 vjeçare për femrat me atë që individ gëzon të drejtën e pensionimit të parakohëshëm edhe atë 63 vjeçar për meshkujt dhe 62 vjeçar për femrat por pagan penalti në formë të shkurtimit të pensionit për 6.8% për secilin vit të pensionimit të parakohëshëm. Shtylla e dytë është në përdorim, megjithatë deri në vitin 2025 është në zbatim eksperimental. Shtylla e tretë, ngjashëm si në vende tjera është shtylla e sigurimit privat pensional me qëllim të përkujdesjes se edhe pas pensionimit individët do të jenë në gjeinde të ruajnë standardin jetësorë që kanë patur në përriudhën kur kanë qenë të punësuar.²⁰

Kur janë në pyetje sistemet pensionale të vendeve anëtare të Unionit Evropian, analizat e Komisionit Evropian, në suaza të raporteve specifike sipas vendeve për vitin 2019 nxjerrin në pah aspektet, problemet, sfidat dhe pritjet e paraqitura në tabelën vijuese, tab.1.x.

Tab.1.6 Projektione për zhvillimin e sistemeve pensionale të disa shteteve anëtare të Unionit

²⁰ Për më gjerësishtë rreth kësaj konsulto: Maria Verena Bronbacher Steiner: *"The Swiss Three-Pillar Model"*, Axel H. Barsch-Supan (Ed), Meinhard Miegel (Ed): **Pension Reform in Six Countries: What Can Be Learned From Each Other**, Springer-Verlag, 2001, 69-86

Evropian sipas analizave të komisionit evropian	
Shteti	Sqarime
Belgjika	- Në afat të mesëm do të vijë deri në përkeqësim të stabilitetit të sistemit pensional; - Do të vijë deri në zgjatje të konsiderueshme të periudhës së shfrytëzimit të pensioneve si rezultat i zgjatjes së jetëgjatësisë; - Risikot nga varfëria në mesin e pensionistëve do të zvogëlohen në të ardhmen.
Bullgaria	Edhe pranë ndryshimeve të realizuara pensioni më i ulët në Bullgari është nën kufirin e varfërisë potenciale për pensionistët.
Çekia	Masat e reja qeveritare ndonëse mundet ta bëjnë sistemin pensional më adekuat, e vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tij.
Gjermania	Garantimi i pensioneve në afate më të gjata kohore mundet të kërkojë ndërhyrje strukturore.
Greqia	Reformat e ndërmara në vitin 2016 kanë siguruar qëndrueshmërinë e sistemit pensional.
Irlanda	Qëndrueshmëria afatgjatë financiare e sistemit pensional është mjaft sfiduese

Pra, siç mundet të vërhet nga tabela e mëlartme shqetësimet kryesore në suaza të Unionit Evropian kanë të bëjnë më qëndrueshmërinë financiare të sistemeve të sigurimit pensional edhe pranë faktit që aktualisht pjesa më e madhe e tyre nuk janë duke u ballafaquar me probleme të veçanta në këtë drejtim.

Në tabelën vijuese janë të paraqitura të dhëna mbi mënyrën e organizimit të sigurimit pensional në disa vende të kontinentit Evropian, përkatësisht vende anëtare të Unionit Evropian, tab.1.x.

Tab.1.7. Sigurimi pensional në disa vende të Unionit Evropian

Ginia	Pensionimi i rregullt		Pensionim i hershëm
	Mosha	Vitet e sigurimit	
Hungaria			
Femrat	62	Shtylla e parë: 15 vite Shtylla e dytë: nuk ka minimum të përcaktuar	Opsion vetëm për profesione të veçanta. Në këto raste personi mundet të pesnsionohet dy vite më herët me kusht në profesion të ketë qenë aktiv së paku 8 vite, ndërsa për çdo katër vite shtesë përvojë për një vit shkurtohet mosha minimale për pensionim.
Meshkujt	62	Shtylla e parë: 15 vite Shtylla e dytë: nuk ka minimum të përcaktuar	Opsion vetëm për profesione të veçanta. Në këto raste personi mundet të pesnsionohet dy vite më herët me kusht në profesion të ketë qenë aktiv së paku 10 vite, ndërsa për çdo pesë vite shtesë përvojë për një vit shkurtohet mosha minimale për pensionim,
Polonia			
Femrat	60	Pension minimal i garantuar për përvojë së paku 20 vjeçare. Për personat e lindur para 1.1.1949 nevojiten së paku 15 vite përvojë pune, ndërsa për ato të lindur pas kësaj date nuk ekziston minimum i përcaktuar.	Për personat e lindur para 1.1.1949- të moshës së paku 55 vjeçare me periudhë së paku 30 vjeçare kualifikuese.
Meshkujt	65	Pension minimal i garantuar për përvojë së paku 25 vjeçare. Për personat e lindur para 1.1.1949 nevojiten së paku 20 vite	

		përvojë pune, ndërsa për ato të lindur pas kësaj date nuk ekziston minimum i përcaktuar.	
Çekia			
Femra	56-60	25 vitë sigurim; 15 për personat që kanë mbushur 65 vjet	3 vite para moshës së pensionimit të rregullt
Meshkuj	61.8	25 vitë sigurim; 15 për personat që kanë mbushur 65 vjet	
Sllovakia			
Femra	56-60 në mvarësi nga numri i fëmijëve	10	E mundur me kusht të ketë qenë personi së paku 10 vite i siguruar.
Meshkuj	62	10	
Estonia			
Femrat	60	Shtylla e parë:15 vite.	3 vite para moshës së pensionimit të rregullt
Meshkujt	63	Shtylla e dytë:5 vite	
Sllovenia			
Femrat	60 vite e 8 muaj	20 vite përvojë pune	58 (38 vjet përvojë)
Meshkujt	62		58 (40 vjet përvojë)
Burimi: Leszek Kasek, Thomas Laursen, Emilia Skrok: “Sustainability of Pension Systems in the Neë EU Member States and Croatia: Coping ëith Aging Challenges and Fiscal Pressures”, Eorld Bank Eorlking Paper, No.129, 2008			

Pra, siç mundet të vërehet , vendet e ndryshme kanë përcaktuar edhe mënyra të ndryshme për përcaktim të moshës së pensionimit, me atë që shtete të caktuara, siç është rasti

me Sllovakinë, si kriter për pensionim të personave të gjinisë femërore kanë përcaktuar edhe numrin e fëmijëve që ato e kanë rritur. Krahas kësaj duhet theksuar se në të shumtën e rasteve janë përcaktuar edhe mundësi për pensionim të parakohëshëm të individëve përkatës.

4.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Mbretërinë e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar rregullishtë është konsideruar si një nga vendet me sistemet më të avansuara të sigurimit pensional në botë, por njërendi edhe me një nga sistemet më komplekse. Kështu në Mbretërinë e Bashkuar ekzistojnë sisteme të ndryshme të sistemit të sigurimit pensional që mundësojnë opsionin sipas së cilit punëtori vetë financon pensionin e tij, sistem sipas së cilit punëdhënësit financojnë pensionet e punonjësve e deri në mundësinë që persona të tretë të bëjnë pagesa për mbushje të fondit pensional të një individi të caktuar.²¹

Sot në Britaninë e Madhe paralelishtë funksionojnë dy sisteme të sigurimit pensional edhe atë sigurimi pensional minimal dhe modeli i ri i sigurimit pensional bazik.

Pjesë e sistemit të pensionit bazik shtetërorë janë të gjithë meshkujt e lindur para datës 6.Prill.1951 dhe femrat e lindura para datës 6.Prill.1953, në çrast të ardhurat maksimale që mundet të realizohen në emër të pensionit janë diçka më pak se 520 stërlina britanike në muaj. Por, për të fituar qasje në këtë pension, personi duhet të ketë kontribuar së paku 30 vite. Çdo vit bëhet zmadhim i pensionit ose në bazë të rritjes së pagave ose të çmimeve, në çrast për bazë merret kategoria që ka shënuar rritje më të madhe, por jo më pak se 2.5% në bazë vjetore.²²

Meshkujt e lindur më datë 6.Prill. 1951 ose më vonë dhe femrat e lindura më datë 6.Prill.1953, bëjnë pjesë në sistemin e ri të sigurimit pensional me kusht të enë kontribuar së paku dhjetë vite. Këto persona pranojnë pensione diç më të larta, edhe atë maksimum afro 675

²¹ <https://www.pensionsadvisoryservice.org.uk/about-pensions/pensions-basics/different-uk-pension-schemes>

²² <https://www.gov.uk/state-pension/eligibility>

stërlina Britanike në muaj. Këto persona gazojnë të drejtën e vonimit të pensionimi, që rezulton edhe me zmadhim të ardhurave mujore në emër të pensionit.²³ Pra, në esencë personat e pensionuar para datës 6.Prill.2016 janë pensionuar sipas modelit të vjetër të sistemit të sigurimit pensional, ndërsa të tjerët sipas modelit të ri të sistemit të sigurimit pensional.

5.Shkurtimishtë mbi zhvillimin e sigurimit pensional në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kur bëhet fjalë për sigurimin e sistemit pensional në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duhet theksuar se i njëjti ka kaluar një periudhë të evolucionit mjaft të gjatë, duke filluar që nga fillimi i shek. XVIII. Megjithatë, ajo që është specifike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra iniciativa private, ka shënuar edhe zhvillimin e sistemit të sigurimit pensional në këtë vend. Kështu, që në vitin 1717 Kisha Presbiretiane ka themeluar një fod të veçantë finnaciare me qëllim të ofrimit të përkrahjes financiare për proftërinjtë pas përfundimit të periudhës së shërbimit aktiv të tyre në Kishë. Një shekull më vonë, përkatësisht rreth vitit 1884 Hekurudhat e Baltimorit dhe Ohajos janë bërë organizata e parë më e madhe afariste e cila ka paraparë një lloj sigurimi pensional për punonjësit e tyre. Në rastin konkret, punëtorët me përvojë s'ëpaku dhjetëvjeçare kanë fituar të drejtën e pensionimit në moshë 65 vjeçare në ç'rast u janë garantuar të ardhura në nivel midis 1/5 dhe 1/3 e pagës që kanë realizuar si të punësuar në këtë organizatë.

Sistemi i sigurimit social i Shteteve të Bashkuara të Amerikës përkujdeset për pensionet e punëtorëve që plotësojnë kushtet si dhe bashkëshortëve të tyre. Personat e punësuar dhe kompanitë e tyre derdhin kontribute në sistemin e sigurimit social. Individët gëzojnë të drejtën e qasjes ndaj beneficioneve të pensionimit në moshën 62 vjeçare, megjithëse këto beneficione rriten në rastet kur personi mbetet aktiv në tregun e punës edhe pas kësaj moshe. Vetë personi ka obligim të regjistrohet (paraqitet) për të aktivizuar pensionin

²³ <https://ëëë.gov.uk/neë-state-pension/ëhat-youll-get>

e tij, ndërsa të dhënat dëshmojnë se pjesa dërmuese e qytetarëve këtë aktivizim e bëjnë para se të mbushin moshën 65 vjeçare. Niveli i beneficionit që merr pensionisti përcaktohet në bazë të historikut të ardhurave që ai ose bashkëshortja kanë realizuar gjatë karrierës profesionale, andaj personat që kanë realizuar gjatë periudhës aktive më shumë të ardhura, edhe gëzojnë të ardhura më të larta mujore në bazë të pensionit. Niveli i të ardhurave përcaktohet në bazë të një formule progresive të beneficioneve. Krahas kësaj, bëhet edhe ponderimi i nivelit të beneficioneve me kostot e jetesës, dhe për pasojë beneficionet shënojnë rritje me kalimin e kohës. Beneficionet pensionale i përkasin pensionistit deri në vdekje, ndërsa pas kësaj një pjesë e tyre vazhdon ti paguhet bashkëshortit/es derisa edhe ai/ajo të ndërojë jetë.²⁴

Në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sistemi pensional është i përcaktuar përmes Employee Retirement Income Security Act, një ligj federal që është në fuqi që nga viti 1974. Ligji në fjalë , ofron dy lloje të planeve pensionale, edhe atë:²⁵

- Plane të beneficioneve të parapërcaktuara. Këto planë garantojnë bënëficine të parapërcaktuara mujore me aktin e pensionimit.
- Plane të kontributeve të parapërcaktuara. Sipas kësaj qasje punëtori ose punëdhënësi (ose që të dy) kontribuojnë në mbushjen e llogarisë personale të punëtorit, kontribute këto që më pas investohen në emër të punëtorit. Në këtë kategori bëjnë pjesë planet 401 (k), 403 (b), planet për pronësi të punëtorëve mbi aksionet dhe planet e participimit në fitim.

²⁴ John Besears, James J. Choi, David Laibson, Brigitte C. Madrian: *"The Importance of Default Options for Retirement Saving Outcomes: Evidence from the USA"*, Stephen J. Kay (Ed), Tapen Sinha (Ed): **Lessons from Pension Reform in the Americas**, Oxford University Press, 2008, 60

²⁵ Marrë nga qaqja zyrtare e U.S. Department of Labor në lidhëse dol.gov/general/topic/retirement

KREU

2

E DREJTA PENSIONALE NË MAQEDONINË E VERIUT



1. Sigurimi i të drejtës pensionale gjatë periudhes së monizmit.
2. Sigurimi i të drejtës pensionale pas pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut nga ish federata Jugosllave.
3. Përfitimi i të drejtave të pensioneve në bazë të pleqërisë, invaliditetit dhe asaj familjare
4. Arritja, shfrytëzimi si dhe humbja e të drejtës së pensionit.
5. Sigurimi i fondeve, si dhe mënyra a pagesave të pensioneve në Maqedoninë e Veriut

1.Sigurimi i të drejtës pensionale gjatë periudhes së monizmit

Duke filluar qe nga lufta e dyte boterore, sigurimi social ka qene nje nga te drejtat themelore te njeriut dhe si e tille kishte vendin e vet edhe ne kushtetuten e asaj kohe mirepo duke pasur parasysh qe lufta e dyte boterore la nje katastrofe te madhe si per vendin, popullaten qe humben jete njerzish, gjithashtu la pasoja te medhaja edhe ne sigurimin social qe nuk mundi aq shpejt qe te beje realizimin e te drejtes ne mase te madhe duke pasur parasysh, sepse nuk kishte edhe mundesi materiale per ta realizur kete te drejte.

* Ne vitin 1942 dhe 1943, u mbajte konference ne Berlin dhe ne Budapest ne te cilen ishte kryer ndarja e aseteve shogerore midis autoriteteve vendase dhe pushtuesve²⁶.

Demet e sigurimit shoqëror në kohën e luftës arriti rreth 3.2 miliardë dinarë. Në qoftë se nuk do të kishte okupim, pasuritë e sigurimeve shoqërore do të ishin rritur sipas vlerësimit të autorit deri në 4 miliardë dinarë.²⁷

Dhe ne vitin 1945 per te permiresuar sistemin e sigurimeve u morr vendimi per ndihme te parakoshme per personat qe marrin grante ne zyren e sigurimit te punonjesve te cilat shumen qe e pranonin me ligj si ne forme pensioni dhe e cila nuk arrinte shumen me te madhe se 6.000 dinare.

Te gjithë personat që në vitin 1925 ishin në marrëdhënie pune dhe në vitin 1945 i kishin mbushur 65 vite jete (burra) gjegjësisht 60 vite pleqëri (gra) e fituan të drejtën për pension të pleqërisë. Gjithashtu këto vite ka pasur ndryshime të mëdha në lidhje me sigurimet shoqërore që si e si të vinë deri të një stabilizimi të mundshëm në sferën e sigurimeve shoqërore, kështu që gjithashtu në vitin 1950 pati një ndryshim të ligjit për arritjen dhe fitimin e të drejtës së pensionit në bazë të pleqërisë që do të thotë se kriteriumi për dalje në pension në bazë të pleqërisë u deshtë që të ketë 35 vite stazh pune për burra dhe 30 vite stazh pune për gratë dhe


26

njekohesisht qe burri duhet qe ti kete pos 65 vite te plota gjegjesisht 55 vite gruaja dhe te pakten 15 vite stazh pune.

Kur eshte fjala per ndryshime ne sigurimin pensional qe nga viti 1952 jane bere disa here ndryshime ne lidhje me llogaritjen e bazes se pensioneve. Prej mbarimit te luftes se dyte botrore deri ne vitin 1964 ka pasur ndryshime drastike dhe poashtu ishte vitit 1964 qe u be ndryshimi i ligjit i cili iu pergjigj disa reformave qe pesuan ndryshim ne ndrysimin e kufirit te pleqerise, por u be ndryshimi edhe me sistem tjetër finansimi.

Gjithashtu me ndryshimin e ligjit te vitit 1972 per dalje ne pension i siguruari eshte dashur te kete mbushur 60 vite (burre) gjegjesisht 55 vite (grua) dhe se paku 20 vite stazh pune, keto ndryshime dhe tendenca qe u bene me sigurimet shoqerore kulmuan ne fundin e vitit 1980 dhe ky vit ka ndikuar ne nje mase shume te madhe ne rregullimin dhe zhvillimin e metejshe me te sigurimit te pensioneve .

Sistemi i pensioneve ne rrethanat e fundit politike dhe ekonomike sidomos pas shperberjes se ish Jugosllavise kane bere perpjekje ne ket drejtim per te ndryshuar por te gjitha kane qene te pasuksesshme ndersa rrezimi total dhe i pergjithshem i sistemit te pensioneve ka qene gjithashtu si rezultat i rrenimit te sistemit politik dhe ekonomik. Gjithashtu raporti i pensionisteve dhe kontribuesve aktiv filloi te deformathej per shkak te nje kombinimi te pafavorshem demografik dhe rritjes se papunesise qe do ta tregojmë edhe ne grafikun vijues.



2.Sigurimi i të drejtës pensionale pas pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut nga ish federata Jugosllave

Ne Republikën e Maqedonisë së Veriut pas pamvarsimit nga ish republika Jugosllave ka pasur disa here ndryshime në ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, kështu që nga viti 2006 ekzistojnë tre lloje skemash të pensioneve që kanë pësuar ndryshime nga disa vite më parë, pasi që duke e përshtatur atë me disa vende tjera të zhvilluara të botës që operojnë (funksionojnë) sipas sistemit me disa shtylla të ndryshme që do të thotë sistemi shumëshyllësh i cili aplikohet në vendin tonë, dhe që funksionon me sistem tri shyllësh.

Shtylla e parë është sigurim pensional i detyrueshëm me finansim kapital dmth ajo ekzistuesja që është e bazuar me sistemin solidar, pra kontributet që ndahen nga paga e të punësuarit nuk do të shërbejnë pensionit të tij, por do të shërbejnë për pagesat e pensioneve të të moshuarëve që tashmë kanë plotësuar kushtin për në pension. Por kjo skemë sigurohet edhe me mbështetjen finansiare të shtetit sepse i ka të përcaktuara me ligj dhe pensionet maksimale edhe pensionet minimale²⁸.

Shtylla e dytë është sigurim pensional vullnetar dhe që nga 1 janari i vitit 2006 edhe i detyrueshëm që nënkupton një sistem kursimesh të cilet punonjësve përveç kontributit në shtyllën e parë detyrimisht i ndajnë mjete në përqindje edhe në shtyllën e dytë, që do të thotë se pasi që i siguruari e plotëson kushtin për në pension i siguruari e përfiton edhe kontributin e akumuluar nga ky sistem.

Shtylla e tretë në bazë të kursimit të kapitalizuar që është pak a shumë e ngjajshme me shtyllën e dytë dhe do të thotë punonjësit (të siguruarit) vullnetarisht kontributin e tyre shtesë mund ta rrisin edhe në nivelin e pensionit të tyre të ardhshëm. Ky sistem kryesisht fokusohet në reduktimin e varferisë. Në lidhje me futjen e këtyre dy skemave në sistem, ndihmon në arritjen e tërësishme në plan afatgjatë konkretisht në kohën e pleqërisë.

3.Përfitimi i të drejtave të pensioneve në bazë të pleqërisë, invaliditetit dhe asaj familjare

Siqe dihet i siguruari per te fituar te drejten e pensionit te pleqerise duhet paraprakisht qe ti plotesoje edhe kushtet baze qe jane te caktuara edhe me ligjin e R.M.V

Keshtu qe per te realizuar te drejten e pensionit ne baze te pleqerise duhet qe i siguruari ti kete te mbushura vitet e pleqerise qe do te thote ne momentin e dorezimit apo me konkretisht ne momentin qe duhet ta perfitoje te drejten per pensionin e pleqerise duhet ti kete te mbushura 64 vite moshe te pleqerise dhe te pakten minimum 15 vite pervojje pune efektive.

Keshtu qe kur duhet perfitimi i pensionit per gjinine femrore (grua) gjithashtu duhet ti kete 15 vite pervojje pune efektive dhe 62 vite moshe te pleqerise. Dmth ky eshte kushti kryesor per te perfituar nje pension ne baze te pleqerise, mirepo per te ardhur deri te realizimi i te drejtes ne baze te pleqerise i siguruari (burri apo Gruaja) mundet ta perfiton apo ta realizon ate te drejte nese gjate kohes se punes ka qene i siguruar me stazh te benificuar, konkretisht ekzistojne disa lloje te stazhit te benificuar qe do ti ceki me poshte.

Kur te siguruarit stazhi i llogaritet me i madh si psh

12/13 > do te thote cdo shtate vite pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension.

12/14 > do te thote cdo gjashte vite pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension.

12/15 > do te thote cdo pese vite pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension.

12/16 > do te thote cdo kater vite pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension.

12/17 > do te thote cdo tre vite e gjysem pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension

12/18 > do te thote cdo tre vite pune efektive i zvoglohet 1 vit para kohe ne pension.

Pensioni i moshes se pleqerise arrihet duke i plotesuar kushtet e lartepermenduara dhe duke iu vertetuar i gjithë stazhi i punes, sepse po nga ai stazh pune fitohet edhe perqindja e pensionit qe do te thote se eshte njera nder kushtet thmelore baze dhe gjithashtu edhe rrogat baze te te siguruarit prej viteve te para te punes e deri te perfundimi i marredhenjes se punes dhe po nga keto dy elemente i siguruari e perfiton edhe shumen e pensionit.

*** Ligji 193 b pension pleqerie per personat e siguruar nga neni 11,12,dhe 13 te ketij ligji qe kane qene te mbuluar nga pensioni i detyrueshem dhe sigurimi i aftesise se kufizuar deri me 1 shtator 2001 dhe qe nuk kane zgjedhur te perfshihen ne sigurime te detyrueshme te finansuara plotesisht dhe kane pervoje te plote te perfunduar te pakten 15 vite pervoje pune , do te terhiqet nga baza e pensionit ne varesi te kohezgjatjes se pensionit dhe do te jete:

stazh pune	perqindja	
Vitet	burri	gruaja
15 vite	35	40
15 vite e gjashte muaj	35,9	41,3
16 vite	36,8	42,6
16 vite e gjashte muaj	37,7	43,9
17 vite	38,6	45,2
17 vite e gjashte muaj	39,5	46,5
18 vite	40,4	47,8
18 vite e gjashte muaj	41,3	49,1
19 vite	42,2	50,4
19 vite e gjashte muaj	43,1	51,7
20 vite	44,0	53,0
20 vite e gjashte muaj	44,9	53,9
21 vite	45,8	54,8
21 vite e gjashte muaj	46,7	55,7
22 vite	47,6	56,6
22 vite e gjashte muaj	48,5	57,5
23 vite	49,4	58,4
23 vite e gjashte muaj	50,3	59,3
24 vite	51,2	60,2
24 vite e gjashte muaj	52,1	61,1
25 vite	53,0	62,0
25 vite e gjashte muaj	53,9	62,9

26 vite	54,8	63,8
26 vite e gjashte muaj	55,7	64,7
27 vite	56,6	65,6
27 vite e gjashte muaj	57,5	66,5
28 vite	58,4	67,4
28 vite e gjashte muaj	59,3	68,3
29 vite	60,2	69,2
29 vite e gjashte muaj	61,1	70,1
30 vite	62,0	71,0
30 vite e gjashte muaj	62,9	71,9
31 vite	63,8	72,8
31 vite e gjashte muaj	64,7	73,7
32 vite	65,6	74,6
32 vite e gjashte muaj	66,5	75,5
33 vite	67,4	76,4
33 vite e gjashte muaj	68,3	77,3
34 vite	70,1	79,1
34 vite e gjashte muaj	70,1	79,1
35 vite	71,0	80,0
35 vite e gjashte muaj	71,0	
36 vite	72,8	
36 vite e gjashte muaj	73,7	
37 vite	74,6	
37 vite e gjashte muaj		
38 vite	76,4	
38 vite e gjashte muaj	77,3	
39 vite	78,2	
39 vite e gjashte muaj	79,1	
40 vite	80,0	

Burimi: *** zakon za penzisko i invalidsko osiguruvanje na Republika Severna Makedonija JP Sluzben vesnik na RSM Skopje 2006²⁹

Pensionin në bazë të invaliditetit për të ardhur deri të përfitimi i të drejtës pensionale në bazë të invaliditetit gjithashtu i siguruari se pari duhet të plotësojë disa kushte bazë që të vijë deri të e drejta pensionale në bazë të invaliditetit.

Kushti i parë është që i siguruari në aspektin profesional të ketë paaftësi profesionale për punë paaftësi të përgjithshme për punë dhe kushti i dytë është që i siguruari në aspektin

²⁹ Te dhëna nga Fondi Pensional i Republikës së Maqedonisë së Veriut

juridik duhet te kete stazh pune mvaresisht nga mosha e te siguruarit psh nese i siguruari eshte i moshes mbi 45 vjet per ta arritur te drejten ne baze te invaliditetit i duhen me se paku 12 vite pervoje pune edhe pamvarsisht aspektit profesional qe do te thote se edhe nese e ploteson kushtin e pare ne baze te invaliditetit nuk arrihet e drejta invalide pa pasur 12 vite pervoje pune te pranuar dhe te evidentuara.

Ndersa nese i siguruari eshte i moshes 45 vite ateher ekziston formula qe lidhet edhe me shkollimin dhe qe do ta paraqesim ne tabelen e meposhtme.

Aftesia e kufizuar ne kuptimin e ketij ligji ekziston kur i siguruari per shkak te ndryshimeve te perhershme ne gjendjen shendetsore, shkaqet e demtimit ne pune, semundje profesionale me demtim jashte punes ose me semundje qe nuk mund te sherohet me ane te trajtimit ose masave te rehabilitimit mjeksor, zvoglohen ose humbin aftesine per te bere punen ne punen qe ai ose ajo ka qene i caktuar para aftesise se kufizuar.

Vlersimi i aftesise se kufizuar nuk ka rendesi shkaku i aftesise se kufizuar kjo do te thote se mund te jete nje demtim profesional ose semundje profesionale me te cilen i siguruari e fiton te drejten ne baze te invaliditetit, keshtu qe komisioni kompetent i shkalles se pare sjell mendimin per te drejten e invaliditetit per te siguruarin dhe lenden e adreson deri te fondi si sigurimit pensional per te sjellur vendimin ne shkallet e pare, gjithashtu shkalla e pare ne fondin e sigurimit pensional e ben shqyrtimin e lendes dhe nese mendimi i komisionit eshte pozitiv, ateher shkalla e pare prane fondit e shqyrton lenden se a ka te drejte per pension invalide edhe ne aspektin juridik qe do te thote se a ka stazhin e punes per ta perfituar ate te drejte dhe keshtu sjelle vendimin perfundimtare per te drejten e pensionit.

Perfitimi i te drejtes se pensionit familjare, pensionin familjare mund ta fitojne antaret e familjes:

1) Bashkeshortet

2) Femijet ne martese gjithashtu femijet jashtemartesore dhe femijet e adaptuar niper dhe mbesa femije te tjere jetim te perkrahur nga i siguruari.

Antaret e familjes e perfitojne te drejten per puension familjar nese i siguruari (i vdekuri)

a) Ka mbushur me se paku 5 vite pervoje pune

b) Ka plotesuar kerkesat per pension pleqerie ose invaliditeti

c) Ka qene shfrytzues i pensionit te invaliditetit.

Nese vdekja e te siguruarit ka ndodhur si pasoje e demtimit ne pune ose semundje profesionale , antaret e familjes e fitojne te drejten per pension familjare pa marr parasysht gjatesine e stazhit punes te siguruarit.

E veja e fiton te drejten e pensionit familjare nese:

1) deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortit i ka te mbushura 50 vjet

2) Deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortit ka qene jo i afte per pune ose paaftesia ka ndodhur ne afat prej 1 viti nga vdekja e bashkeshortit .

3) Mbas vdekjes se bashkeshortit kane mbetur 1 ose me teper femije me te ri se te moshes 26 vjecare dhe gjithashtu te jene ne shkollim gjegjesisht te kene statusin e nxenesit dhe e veja te ti kryje obligimet familjare ndaj atyre femijeve ose

4) Deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortit ka pasur 45 vjet te mbushura dhe ne momentin qe i ka te plotesuar 50 vite e fiton te drejten per pension familjare ose

5) nese mbreda ketyre viteve behet behet jo e afte per pune, ndersa i veji e fiton te drejten e pensionit familjare nese

1) Deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortes i ka te mbushur 55 vite jete.

2) Deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortes ka qene jo i afte per pune ose paaftesia i ka ndodhur ne afat 1 vit nga vdekja e bashkeshortes .

3) Mbas vdekjes se bashkeshortes i ka ngelur nje ose me teper femije nga kjo bashkeshortes, ndersa i veji ka femije dhe njekohesisht i kryne detyrat prindore ndaj atyre femijeve.

4) Deri ne momentin e vdekjes se bashkeshortes i ka pas mbushur 50 vite dhe kur ti mbushe 55 vite jete ose nese mbrenda ketyre viteve i paraqitet paaftesi per pune.

Femija e fiton te drejten e pensionit familjare:

1) Deri ne moshen 15 vjecae , ndersa nese eshte ne shkollim dhe ka status te nxenesit deri ne moshen 26 vjecare.

2) Nese para vdekjes se te siguruarit gjegjesisht shfrytezuesit te pensionit i cili e mbeshteti ishte i paaftes per pune ose ajo paaftesi ka ndodhur ne afat prej 1 viti nga vdekja e prindit apo shfrytezuesit te pensioneve.

Gjithashtu femija e mban te drejten e pensionit edhe sikur ta beje nderprerjen e shkollimit pershkak te ndonje semundje te drejten e pensionit familjare do ta shrytezoje deri ne moshen 26 vjecare, poashtu ne kohen kur eshte shfrytezues i pensionit familjare femiju nese behet jo i afte per pune ateher pergjithmone e fitone te drejten e pensionit familjare.

Duhet theksuar se pensioni percaktohet nga pensioni i pleqerisre ose i invaliditetit te cilit i ka takuar shfrytezuseit te pensionit gjegjesisht te siguruarit te i cili i ka takuar para vdekjes.

Shuma e pensionit familjare nga pensioni o pleqerise ose i invaliditetit mirret 70% per nje anetar dhe per cdo anetar apo pasues mirret 10%dhe jo me teper se 100% prej bases.

4.Arritja, shfrytëzimi si dhe humbja e të drejtës së pensionit

Te drejten per pension dhe sigurim te aftesise se kufizuar mund ta arrije nje person qe ka statusin e nje personi te siguruar sipas ligjit (ligji 133).

*** ne proceduren e realizimit te te drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor rendesi te madhe ka vlersimi i aftesise per pune te te siguruarit, sepse nese ekziston invaliditet apo demtim trupor realizohen edhe te drejtat materiale afatgjata nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor.

Psh ne vitin 2018 komisioni per vleresimin e aftesise per pune punonte ne 3 perberje me nga 2 antare mjek, specialist dhe 1 mjek specialist udheheqes me cka rregullisht dhe ne kohe e sjellin edhe konstatimin, vlersimin dhe mendimin per te cilen edhe arrihet e drejta, ndersa kur behet fjale per arritje te drejtes ne baze te pleqerise apo asaj familjare i kemi cekur me lart .

Pas fitimit te drejtes ne baze te invaliditetit, i siguruari gjegjesisht pensioneri e humbet te drejten e shfrytezimit te asaj nese konstatohet se i njeiti ka bere ndonje lajmerim ne pune qe do te thote se ne kete reast automatikisht e humbet te drejten e shfrytezimit te pensionit invalidor cka do te thote se fondi i sigurimit pensional dhe invalidor ne shkalle te pare ia sjell vendimin negativ ku edhe ia nderpret te drejten per shfrytezim te pensionit invalidor.

Gjithashtu humbja e te drejtes se pensionit ne baze te pleqerise poashtu humbet e drejta e pensionit nese konstatohet lajmrir i ri ne pune pasi qe i njeiti ta kete statusin e pensionistit.

Ndersa pensiononet familjare e drejta humbet psh nese eshte shfrytezues i pensionit femiu i cili shkollohet dmth e ka statusin e nxenesit dhe e nderpret shkollimin, ne ate moment ne menyre automatike shkalla e pare prane fondit pennsional dhe invalidor sjell vendim negativ per nderprerjen e asaj te drejte.

5.Sigurimi i fondeve, si dhe mënyra a pagesave të pensioneve në

Maqedoninë e Veriut

Sigurimi i fondeve apo (mjeteve) per sigurim pensional dhe invalidor, sigurohen nga:

Nga të ardhurat burimore (kontribut nga paga, stazhi i sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, kontribut nga personat fizik të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari, të punësuar tek ata si dhe nga bujqit individual dhe Agjencia e punësimit) janë realizuar

mjete në shumë prej 37.990,40 milion denarë apo 55,18% nga gjithsej të hyrat, Mjetet nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 29.391,94 milion denarë apo 42,69% nga gjithsej të hyrat,

Nga akcizat janë realizuar mjete në shumë prej 1.346,96 milion denarë apo 1,96% nga gjithsej të hyrat,

Nga dividenda janë realizuar mjete në shumë prej 3,55 milion denarë të cilat në krahasim me gjithsej të hyrat arrijnë 0,005%.

Nga shitja e aksioneve dhe pjesëve janë realizuar mjete në shumë prej 16,86 milion denarë, apo 0,02%.

Nga të ardhurat e tjera janë realizuar mjete në shumë prej 102,76 milion denarë apo 0,15% nga gjithsej të hyrat. Kontributi nga paga llogaritet dhe paguhet në shkallë prej 18% të bruto pagës dhe është burim kryesor për financimin e Fondit. Kontributet e paguara Fondi i shpërndan ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë pensionale. Shpërndarja e kontributit në vitin 2018 përmes shtyllës së parë dhe të dytë me hyrjen e Ligjit të ri në fuqi për sigurim pensional dhe invalidor, prej 08.08.2012, u përcaktua shkallë fikse e kontributit për shtyllën e parë prej 12%, ndërsa për shtyllën e dytë prej 6%. Në vitin 2018 nga kontributet e pagës, janë realizuar mjete në shumë prej 36.565,66 milion denarë dhe të njëjtat arrijnë 100,46% në raport me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit, ndërsa në krahasim me vitin 2017 janë më të larta për 6,75% apo 2.313,9 milion denarë. Pjesëmarrja e kontributit të pagës në të 24 hyrat totale arrin 53,11%. Në rritjen e kontributit nga paga në vitin 2018 ka ndikim edhe pagesa e kontributeve të papaguara, përfundimisht me 31.12.2008, në shumë prej 101,75 milion denarë, gjithsej kontribute nga paga dhe kamatë për pagesë të vonuar të të njëjtave.

Në bazë të evidentimit të fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të R.M.V në dhjetor të vitit 2018 janë evidentuar 86,360 obligues dhe 578,023 të siguruar me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe gjithashtu sipas të dhënave të fondit numri i të siguruarve në dhjetor të vitit 2018 për të cilët paguhet kontribut për 8 deri në 12 muaj arrin 525,095 apo 90,84% nga gjithsejt numri i të siguruarve 578,023.

Duhet te cekim se poashtu ne dhjetor te vitit 2018 numri i te siguruarve arrin ne 578,023 ndersa numri i shfrytezuesve arrin ne 315,780

Nje nder funksionet primare te fondit ne zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor eshte pagesa e perfitimeve pensionale te pensionit. Ne vitin 2018 ne javen e pare te muajit eshte bere pagesa e pensioneve per muajin paraprak.

Rregullisht pergaditen dhe behen pagesa te rregullta mujore per perfituesit e pensioneve nga sigurimi i punes, pensionet ushtarake, pensionet minimale te bujqeve si dhe pagesa ne ish republikat e Jugoslavise dhe transferte.

KREU

3

BASHKËPUNIMI I MAQEDONISË NË SFERËN E SIGURIMIT PENSIONAL ME REPUBLIKËN E GJERMANISË



1. Në përgjithësi mbi bashkëpunimin në sferën e sigurimit pensional.
2. Bashkëpunimi me R. e Gjermanisë para pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut
3. Nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim pas pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut
4. Analiza e rasteve konkrete në sferën e sigurimeve pensionale prej vitit 2003-2019.

1.Në pergjithsi mbi bashkëpunimin ne sferën e sigurimit pensional

Republika e Maqedonise se Veriut dhe Republika Federale e Gjermanise ne sferen e sigurimeve pensionale kane nje bashkepunim shume te shkelqyer dhe shume transparent duke e dalluar nga te gjitha marreveshjet tjera nderkombetare qe ka arritur Republika e maqedonise se Veriut.

Marreveshja bilaterale me Republiken Federale te Gjermanise duhet marre si shembulli me pozitiv dhe shembulli me i mire kur arrihet nje marreveshje me nje shtet tjeter dhe se si duhet funksionuar.

➤ Procedurat per veretimin periudhave

1. Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Republikes se Maqedonise se Veriut e ben kerkesen per vertetimin e periudhes per te siguruarin i cili ne shtetin kontraktues gjegjesisht ne shtetin Gjerman gjate kohes se tij, nje pjes te jetes se tije e ka kaluar ne pune ne Republiken e Gjermanise, dhe poashtu po nga ai shtet e kerkon qe ti vertetohet periudha e kohes punes.

2. Shteti Gjerman mbas pranimi te kerkeses nga Republika e Maqedonise se Veriut, e shqyrton ate kerkes dhe ne afat rekord 2-3 muaj e verteton stazhin e punes per te cilen eshte bere kerkesa, dhe ajo kerkese qe te jete valide e pranuar si stazh pune shteti kontraktues stazhin e punes ia verteton ne formularin dygjuhesor qe eshte ne marreveshjen ekzistuese me Republiken e Gjermanise.

➤ Procedurat per kthimin e kontributeve

Procedurat per kthimin e kontributeve behet me kerkese te pales qe do te thote se nese gjate kohes se tij ka kaluar ne kohe pune i siguruar ne shtetin kontraktues te (Gjermanise)

dhe i ka me pak se 5 vite pervoje pune dhe nuk ka stazh pune ne Republiken e Maqedonise qe te mundet ta beje bashkimin me stazhin qe e ka ne Republiken e Gjermanise ne kete rast nga shteti gjerman nuk e ka kushtin per te fituar te drejten per pension dhe ne keto raste duhet te behet kerkesa per kthimin e kontributeve qe do te thote se ato vite te kaluara shteti gjerman ua bene kthimin e kontributeve po aq sa vite u vertetohet se kane punuar ne ate shtet.

➤ **Procedurat, kerkesa dhe dalja ne pension**

Republika e Gjermanise kushtin kryesor per perfitimin e te drejtes per pension ne baze te moshes se pleqerise e ka:

1. Ne momentin qe duhet ta perfitoj te drejten per pension ne baze te moshes se pleqerise njekohesisht duhet qe te kete mbushur vitet e pleqerise dhe duhet theksuar se Republika e Gjermanise ka bere ndryshimin e ligjit per moshen e daljes ne pension te pleqerise dhe mosha per dalje ne pension nuk eshte statike si me pare qe ka qene 65 vite jete, por ajo varion, dhe nga viti ne vit mosha e pleqerise shkone duke u rritur.

Kete ndryshim te moshes se pleqerise do ta paraqesim ne nje tabele ku do ta kemi me te qarte se per sa vite kemi rritje te moshes se pleqerise, dhe plotesimit te daljes ne pension dhe njekohesisht duhen 5 vite pervoje pune.

Ne rast se i siguruari nuk ka pese vite pervoje pune, mirepo konstatohet dhe vertetohet se i njejti ka stazh pune ne nje shtet apo ne nje shtet te trete, duhet te theksojme se gjermania eshte nje nder shtetet e rralla qe e pranon edhe stazhin nga nje shtet i trete dhe me bashkimin e atyre periudhave te punes nese i siguruari i ka te vertetuara 5 vite e me teper, ne kete rast shteti gjerman ia percakton pensionin mujor dhe i siguruari e fiton ate te drejte per pension nga Republika e Gjermanise.

te rritja e moshes per dalje ne pension ne baze te viteve te pleqerise.

viti i lindjes	Moshe, vit, muaj				reduktim ne %	Moshe, vit, muaj				Moshe, vit, muaj				moshe,vit,m		
1945	65		65	63	7,2	63	60	10,8	65	60	18	65				
1946	65		65	63	7,2	63	60	10,8	65	60-61	17,7-14.4	65				
1947	65/1	65	65	63	7,2	63	60	10,8	65	61-62	14,1-10,8	65				
1948	65/2	65	65	63	7,2	63	60	10,8	65	62-63	10,7-7,2	65				
Jan-49	65/3	65	65/1	63	7,5	63	60	10,8	65	63	7,2	65				
Feb-49	65/3	65	65/2	63	7,8	63	60	10,8	65	63	7,2	65				
Mar-49	65/3	65	65/3	63	8,1	63	60	10,8	65	63	7,2	65				
1950	65/4	65	65/4	63	8,4	63	60	10,8	65	63	7,2	65				
1951	65/5	65	65/5	63	8,7	63	60	10,8	65	63	7,2	65				
1952	65/6	65	65/6	63	9	63/1	60/1	10,8								
1952	65/6	65	65/6	63	9	63/2	60/2	10,8								
1952	65/6	65	65/6	63	9	63/3	60/3	10,8								
1952	65/6	65	65/6	63	9	63/4	60/4	10,8								
1952	65/6	65	65/6	63	9	63/5	60/5	10,8								
6/12/1952	65/6	65	65/6	63		9	63/6	60/6	10,8							
1953	65/7	65	66/7	63	9.3	63/7	60/7	10,8								
1954	65/8	65	66/8	63	9,6	63/8	60/8	10,8								
1955	65/9	65	65/9	63	9.9	63/9	60/9	10,8								
1956	65/10	65	65/10	63	10,2	63/10	60/10	10,8								
1957	65/11	65	65/11	63	10,5	63/11	60/11	10,8								
1958	66	65	66	63	10,8	61	61	10,8								
1959	66/2	65	66/2	63	11,4	61/2	61/2	10,8								
1960	66/4	65	66/4	63	12	61/4	61/4	10,8								
1961	66/6	65	66/6	63	12,6	61/6	61/6	10,8								
1962	66/8	65	66/8	63	13,2	61/8	61/8	10,8								
1963	66/10	65	66/10	63	13,8	61/10	61/10	10,8								
1964	67	65	67	63	14,2	61	62	10,8								

Vlene te theksojme se qytetaret e Republikes Maqedonise se Veriut pasi te kene ardhur deri te perfitimi i te drejtes per shfrytezimin e pensionit nga Republika e Gjermanise eshte i obliguar qe ne cdo gjashte muaj ta informoj fondin e sigurimit pensional te gjermanise qe eshte gjalle, se ne te kunterten fondi i sigurimit te gjermanise sjell vendim per nderprerjen e asaj te drejte per te mos ardhur deri demtimi i buxhetit te tyre.

2.Bashkëpunimi me R. e Gjermanisë para pamvarsimit të Maqedonisë së Veriut

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Republikës Maqedonise se Veriut para pamvarsimit nga ish Republika Jugosllave ka zbatuar ligjin qe ishte ne fuqi dmth bashkepunimi bilateral i lidhur ndermjet Republikës socialiste federative te Jugosollavise me Republikën federative te Gjermanise qe u nenshkrua me 12 tetor te vitit 1968.³⁰

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Republikës se Maqedonise se Veriut i merr persiper detyrimet e permendura ne nenin 2 shkronja b te marreveshjes ne fjale ne lidhje me ish shtetasit e Republikës Jugosllave te permendur ne nenin 1 paragrafi 1 shkronja b te marreveshjes ne fjale.

Nese tashme eshte duku u paguar nje pension sipas nenit 1 paragrafi 1 shkronja b te marrveshjes ne fjale kjo vlen edhe per nje pension qe ploteson kushte te tilla, per persona shtetas te Republikës se Maqedonise se Veriut, per personat qe kane nenshtetesi Gjermane ose te nje shteti te trete me perjashtim te shtetesisë se nje prej shteteve te reja qe ndodhin ne territorin e ish Jugosllavise nese me 1 janar 1956 ata persona posedonin shtetesisë e R.M.V³¹ Kjo marrëveshje dhe marreveshja midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës Federale të ish Jugosllavisë për zgjidhjen e disa kerkesave te caktuara të sigurimeve shoqërore të 10 Marsit 1956 nëse përmban takime për faktet e përmendura në paragrafin e dytë vijues nuk do të jene te vlefshme si marreveshje sipas ligjeve gjermane per pensionet e huaja ato nuk do te ndikojne te ato rregulla.

Nese pas janarit, por para hyrjes ne fuqi te marreveshjes se sigurimeve shoqerore te 12 tetorit te vitit 1968 personi i permendur ne nenin 1 paragrafi 1 shkronja b nga marreveshja, nje antar i familjes se personit te ndjere e ka lene vendbanimin e tijte perhershëm ne territorin e ish Jugosllavise per sa i perket te drejtave te tij dhe te drejta e pritshme te percaktuara ne marrveshje do te zbatohen ne piken e pare dhe te dyte te kesaj pike nga data e nisjes ne vendin

³¹ Zakon za ratifikacija na dogovorot megju Makedonskata vllada i vlladata na sojuzna Republika Germanija za socijalno osiguruvanje

e vendbanimit, nese personi ose antari i familjes se personit te ndjere eshte shtetas gjerman ne daten e aplikimit.

3.Nënshkrimi i marrveshjes per bashkëpunim pas pamvarsikut të Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonise se Veriut, ashtu si qe ka lidhur marreveshje bilaterale per sigurim pensional me shume shtete tjera, gjithashtu ka te lidhur marreveshje bilaterale edhe me Republiken federative te Gjermanise. Ratifikimi i marreveshjes per sigurim pensional ne mes Republikes se Maqedonis se Veriut dhe Republikes Federative te Gjermanise u ratifikua ne Shkup me 8 korrik te vitit 2003.

Ne kete marreveshje parashikohet detyrimi per te siguruar puntoret dhe e cila percaktohet ne perputhje me rregulloret e perkohshme te asaj pale kontraktuese ne cilin territor jane te punesuar. Kjo vlene edhe kur punedhenesi eshte rezident ne territorin e pales tjeter kontraktuese.

Nese nje punonjes i cili eshte i punesuar ne territorin e nje pale kontraktuese dergohet nga punedhensi i tij ne territorin e pales tjeter kontraktuese dmth per te bere atje ndonje pune per ate punedhenes,dhe per ate punesim, gjate 24 muajve te pare kalendarik ekskluzivisht dispozitat ligjore te pales se pare e marrin pergjegjesine per sigurimin, e personit sikur qe personi akoma te ishte i siguruar ne territorin e tij.

Per te perfituar te drejten sipas ligjit ne fuqi do te mirren parasysh periodhat e sigurimit nese ato lidhen apo jane te se njejtës periodhe, qe do te thote se se pari duhet te vertetohen periodhat nese i personi i siguruar mos eventualisht per te njejtin periodhe kohore e ka stazhin e punes te se njejtës periodhe ne dy shtetet kontraktuese, ne rastet e tilla personit te siguruar i paraqitet stazh pune ne te dy shtetet per te njejtën periodhe, atëher personi ka te

drejten ta beje zgjedhjen e vetem njerit shtet.³² Ne zbatimin e nenit 25 dhe paragrafit 2 te ketij neni, Republika e Maqedonise se Veriut do ti marre parasysh te gjitha periudhat e sigurimit te cilat sipas ligjit Gjerman te gjitha do te merren parasysh edhe per llogaritjen e pensionit.

1. Pike se pari llogaritet shuma teorike e perfitimit qe do ti perkiste kur te mblidhen te gjitha periudhat e mbledhura ne paragrafin 1 do te kishin perfunduar ne baze te ligjit te Republikes se maqedonise se Veriut.

2. Poashtu vertetohet shuma reale qe do ti kishte takuar te siguruarit keshtu qe shuma teorike poshte pikes 1 zvoglohet ne raport midis periudhave te sigurimit te perfunduara me ligjin e Republikes se Maqedonise se Veriut.

3. Nese i gjithë stazhi i periudhave te sigurimit te te dyja vendeve jane te plotesuara ne baze te paragrafit 1 me i gjate se kohezgjatja me e gjate e periudhave te sigurimit dhe te percaktuara me rregulloret maqedonase per llogaritjen e shumes se dhene, ateher sigurimi i Republikes se Maqedonise e merr ate kohezgjatjen me te gjate ne vend te gjithsejt periudhave te mbledhura.

4. Analiza e rasteve konkrete në sferën e sigurimeve pensionale prej vitit 2003-2019

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Republikes se Maqedonise se Veriut vazhdon qe ti kryeje punet rrjedhese ne zbatimin e marreveshjeve bilaterale per sigurim social si organ kompetent per te bere realizimin e te drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, gjate realizimit dhe zbatimit te marreveshjeve nderkombetare per sigurim social konkretisht me Republiken e Gjermanise ne sferen e sigurimeve pensionale.

³² Zakon za ratifikacija na dogovorot megju Makedonskata vllada i vlladata na sojuzna Republika Germanija za socijano osiguruvanje

Fondi i sigurimit pensional ne te gjithë territorin e saj i ka edhe njesite rajonale, qe funksionojne ne kuader te fondit pensional me qender ne Shkup.

Kur bisedohet per te siguruarit qe kane stazh pune jashte shtetit te Republikes se Maqedonise konkretisht ne Republiken e Gjermanise, personat drejtohen ne njesite rajonale nga cili qytet jetojne dhe aty parashtrojne kerkesat per pension duke e dorezuar edhe dokumentacionin qe tregon se personi ka punuar ne shtetin gjerman dhe duke u vertetuar se i njejti ka punuar ne ate shtet i formohet lende me stazh te kombinuar me shtet te huaj dhe lenda percillet per ne Shkup ngase Shkupi eshte ura lidhese gjithashtu edhe vendos mbi te drejten per pension.

Pas kompletimit te asaj lende nese e ka kushtin per pension te pamvaruar nga Republika e Maqedonise se Veriut, sjellet vendimi per pension ku i pranohet ajo e drejte, dhe percillet per ne Gjermani gjithashtu nese e ploteson te njejtin kusht edhe ne Republiken e Gjermanise poashtu i sjellet vendimi per prenimin e te drejtes. Mirepo kemi raste kur personi qe e ka bere kerkesen per ta fituar te drejten per pension, nuk ka stazh te mjaftueshem per pension te pamvarur ne Republiken e Maqedonise dhe ne ate rast, fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i R.M.V eshte i obliguar qe te beje kerkese ne shtetin kontraktues qe ti vertetohet stazhi se personi ka punuar ne ate shtet dhe mbas vertetimit te stazhit ne formularin perkates dygjuhesor, i bashkohet stazhi qe e ka ne R.M.V dhe i sjellet vendimi per pranim te asaj te drejte.

Duke filluar nga viti 2003 ateher edhe kur eshte arritur marreveshja bilaterale me Republiken e Gjermanise kekresat te cilat dorezoheshin ne njesite rajonale me stazh te kombinuar dhe per te cilat jane dashur te percillen per ne Shkup, kane zgjatur shume kohe nga shkaku se ne ate periudhe percjellja e lendeve eshte bere me poste, keshtu qe edhe arritja deri te realizimi i te drejtes ka zgjatur shume.

Nga viti 2011 fondi pensional dhe invalidor ne Republiken e Maqedonise se Veriut filloi ta implementoj sistemin elektronik, keshtu qe lendet paralelisht skenohen dhe regjistrohen ne menyre elektronike, qe dmth se qellimi i sistemit elektronik realisht do te thote efikasitet me i lart ne pune dhe zgjidhje te lendeve ne kohe me te shkurter. Mirepo thene shkurt kur behet

fjale per pensione te cilet kan stazh te kombinuar e qe ne kete rast ka edhe procedura me te medha, dhe vonesat jane te medha.

Per te pasur efikasitetin e duhur dhe per te qene me ekspeditiv per zgjidhjen lendeve posacerisht atyre me stazh te kombinuar dhe te kemi zgjidhje te lendes ne afat sa me te shkurter, qe ne fillim te kerkeses duhet respektuar procedurat ligjore, te behet skenimi i lendes dhe ne menyre elektronike te dergohet ne Shkup, dhe kerkesa poashtu ne afat ligjor duhet te percillet ne shtetin kontraktues, ne ate menyre do te kemi efikasitetin e duhur qe lendet sadopak te zgjidhen per nje kohe me te shpejte.

Eshte shume e rendesishme qe te dime se sa shfrytezues te pensioneve paguhen nga Republika e Gjermanise ne Republiken e Maqedonise se Veriut, dhe sa eshte ajo vlere ne euro ?

Në zbatim të nenit 12 të Konventës për Zbatimin e marreveshjes së 8 Korrikut te vitit **2003**, nga fondi gjerman i sigurimeve Bavaria Jugore ne Landshut si organ lidhes sipas Konventës deri më **31.12.2016** jane te paguara gjithsejt **13,693** pensione të përfituesve në Maqedoni.

Behet fjale per :

68 pensione për shkak të aftësisë së zvogëluar të punës

8.423 pensione te pleqerise

5.156 pensione familjare per te veje dhe vejusha

46 pensione familjare per femije.

Gjithesejt per vitin **2017** jane paguar mbi **39 milion €** te transferuara përmes Shërbimit Pensional Gjerman per shfrytezuesit e pensioneve ne Maqedoni.

Në zbatim të nenit 12 të Konventës për Zbatimin e marreveshjes së 8 Korrikut te vitit **2003**, nga fondi gjerman i sigurimeve Bavaria Jugore ne Landshut si organ lidhes sipas Konventës deri më **31.12.2017** jane te paguara gjithsejt **13,478** pensione të përfituesve në Maqedoni.

Behet fjale per :

46 pensione për shkak të aftësisë së zvogëluar të punës

8.273 pensione te pleqerise

5.117 pensione familjare per te veje dhe vejusha

42 pensione familjare per femije.

Gjithesejt per vitin **2017** jane paguar mbi **38,5 milion €** te transferuara permes Shërbimit Pensional Gjerman per shfrytezuesit e pensioneve ne Maqedoni.

Gjithashtu per vitin kalendarik te vitit **2016-te** jane te paguara pensione nga autoriteti federal i sigurimeve pensionale Gjermane per personat te cilet jetojne ne Maqedoni

numri i pensioneve per pages	Lloji perfitimeve	Shuma e paguar ne euro
4	pensionet për shkak të aftësisë së zvogëluar	24000
192	pensione te pleqerise	533000
76	pension familjare	214000
272	gjithesejt	771000

Gjithashtu per vitin kalendarik te vitit **2017-te** jane te paguara pensione nga autoriteti federal i sigurimeve pensionale Gjermane per personat te cilet jetojne ne Maqedoni.

numri i pensioneve per pages	Lloji perfitimeve	Shuma e paguar ne euro
4	pensionet për shkak të aftësisë së zvogëluar	24000
190	pensione te pleqerise	556000
80	pension familjare	206000
274	gjithesejt	786000

Gjithashtu per vitin kalendarik te vitit **2018-te** jane te paguara pensione nga autoriteti federal i sigurimeve pensionale Gjermane per personat te cilet jetojne ne Maqedoni.

Numri i pensioneve per pages	Lloji perfitimeve	Shuma e paguar ne euro
4	pensionet për shkak të aftësisë së zvogëluar	35000
194	pensione te pleqerise	589000
81	pension familjare	236000
279	gjithesejt	860000

shkëmbimi i statistikave midis Republikës Federale të Gjermanisë sipas Konventës gjermano-maqedonase të sigurimeve shoqërore përveç kësaj do te japim një përmbledhje të pensioneve të paguara për kalendarin **2017** dhe sigurojmë të dhëna për numrin e pensioneve të paguara sipas llojit të pensionit.

Lloji i perfitimeve	Numri i pensionistëve	Shuma e paguar në euro		
pensionet për shkak të aftësisë së zvogëluar	0	83,33		
pensione të pleqerisë	326	142.333,33		
pension familjare	248	75.000,00		
gjithsejt	573	217.416,66		

KREU

4

QËNDRIMET E PENSIONISTËVE MBI RËNDËSINË E BASHKËPUNIMIT BILATERAL MES MAQEDONISË SË VERIUT DHE GJERMANISË NË SFERËN E SIGURIMIT PENSIONAL




1. Përshkrim i kampionit
2. Përshkrim i rezultateve
3. Komentim i rezultateve

1.Përshkrim i kampionit

Me qëllim të testimit të hipotezave dhe ofrimit të një analize më të thuktë të bashkëpunimit bilateral në fushën e sigurimit pensional në mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës Federale të Gjermanisë, shikuar nga këndëvështrimi i vetë pensionistëve që janë kthyer në Maqedoni e që gëzojnë befite pensionale Gjermane, është zhvilluar një anketë mjaft ekstenzive me pensionistë nga të gjitha komunat në regjionin e Pollogut. Në fakt, në anketim kanë participuar gjithsej 255 pensionistë që kanë siguruar pension Gjerman dhe më pas janë kthyer në Maqedoni. Bëhet fjalë për një studim mjaft voluminoz të bazuar në një pyetësorë të strukturuar, por vetë studimi është realizuar përmes anketimit, me qëllim të lehtësimit të plotësimit të pyetësorit nga ana e pensionistëve në fjalë, një pjesë e të cilëve janë në moshë mjaft të shtyrë.

Në grafikun vijues është paraqitur struktura gjinore e të anketuarve, graf.4.1.

Graf.4.1. Gjinia e të anketuarve




Siç mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm, mostra është gati tërësisht e dominuar nga të anketuar të gjinisë mashkullore. Në fakt, vetëm 61 të anketuar, përkatësisht 21% i mostrës i përkasin gjinisë femërore, ndërsa 79% janë të anketuar të gjinisë mashkullore.

Në këtë drejtim gjithashtu duhet theksuar fakti se personat e anketuar të gjinisë femërore, që të gjitha gëzojnë pension të trashaguar nga bashkëshortët e tyre të ndjerë, që është një tregues i qartë se pjesa femërore e mërgimtarëve tonë në Gjermani, dhe sipas të gjitha gjasave edhe gjetiu, shumë pak ka qenë aktive përkatesisht e punësuar. Por, nga ana tjetër duhet patur parasysh se bëhet fjalë kryesisht për persona që i pëkrasin asaj që mundet të konsiderohet si gjenerata e parë e mërgimtarëve. Gjithsesi që praktika dëshmon se në këtë drejtim, gjendja është tërësisht e ndryshuar me gjeneratat vijuese të mërgimtarëve.

Në grafikonin vijues janë të paraqitura të dhëna mbi strukturën moshore të personave të kyçur në anketim, graf.4.2.

Graf.4.2. Struktura moshore e të anketuarve




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm pjesa dërmuese e të anketuarve janë të moshës 65-68 vjeçare që nënkupton se bëhet fjalë për persona të pensionuar së fundmi. Në fakt:

- 132 nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar, përkatësisht 52% janë të moshës 65-68 vjeçare.
- Rreth 29%, përkatësisht 73 pensionistë të anketuar janë midis 69 dhe 72 vjeçarë.
- Rreth 15%, përkatësisht 39 nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar janë të moshës 73-75 vjeçare.
- Vetëm 11 pensionistë të anketuar janë të moshës mbi 75 vjeçare.

Në grafikun e mëposhtëm janë të paraqitura të dhëna mbi përkatësinë e pensionistëve sipas komunës, graf.4.3.

Graf.4.3. Struktura e të anketuarve sipas komunës




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, është bërë përpjekje që në anketim të kyçen pensionistë nga të gjitha pjesët e regjionit të Pollogut, ndonëse përfaqësimi nuk është i njejtë. Kjo është rezultat i vështirësive praktike në zbatimin e pyetësorit, për shkak të nevojës së krijimit të rrjetit të kontakteve me qëllim që të kontaktohet pensionistët përkatës. Nga grafiku i mëlartëm gjithashtu mundet të vërehet se mostra është e dominuar nga të anketuar nga komuna e Gostivarit dhe Vrapçishtit. Por, në këtë drejtim duhet theksuar se në suaza të klasifikimit të kësaj natyre janë shfrytëzuar kufijtë gjeografik komfor

ndarjes territoriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kështu, në suaza të komunës së Gostivarit janë përfshirë fshatrat e mëdhenj të Pollogut të Epërm, konkretisht Çeggrani, Forina, Çajla, Balindolli dhe Debreshi, ku edhe gravitojnë pjesa dërmuese e mërgimtarëve në përgjithësi. Në suaza të komunës së Vrapçishtit nga ana tjetër janë përfshirë të anketuarit nga fshatrat si Dobërdolli, Negotina, Gradeci dhe Vrapçishti. Në suaza të komunës së Tetovës, krahas pjesës së qytetit janë përfshirë edhe fshatrat që rrethojnë atë, e në vend të parë Xhepçishti dhe Poroji. Në rastin konkret:

- Rreth 51.7% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Gostivarit.
- Rreth 51.7% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Gostivarit.
- Rreth 21.6% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Vrapçishtit.
- Rreth 51.7% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Gostivarit.
- Rreth 14% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Tetovës.
- Rreth 6.6% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Bogovinës.
- Rreth 3.5% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Tearcës.
- Rreth 2.3% nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar janë nga komuna e Bërvenicës.

Në grafikonin e mëposhtëm është paraqitur struktura e të anketuarve sipas përvojës në punë, graf. 4.4.

Graf.4.4. Struktura e të anketuarve sipas përvojës në punë




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikonin e mëlartëm:

- Mostra është e dominuar nga kategoria e personave me përvojë më të gjatë në punë. Kështu rreth 30% nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë midis 35 dhe 40 vite përvojë pune dhe rreth 6% kanë madje mbi 40 vite përvojë pune. Pra, mbi 1/3 nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë së paku 35 vite përvojë pune.
- Rreth 28.8% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar kanë modos 30 dhe 35 vite përvojë pune.
- Afro ¼ e pensionistëve të anketuar kanë midis 25 dhe 30 vite përvojë pune.
- Afro 13% nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë më pak se 25 vite përvojë pune dhe nga to vetëm 6% kanë më pak se 15 vite përvojë pune.

2.Përshkrim i rezultateve

Studimi nxjerr në pah se në mesin e pensionistëve tonë të kthyer nga Gjermania, shumë pak janë prezente raste të pensionistëve që kanë siguruar beneficione pensionale nga shtylla e tretë e sigurimit pensional në Gjermani, përkatësisht nga situgimi vullnetar, graf. 4.5.


Graf.4.5. Shtyllat e sigurimit pensional Gjerman në mesin e pensionistëve të anketuar



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm që të gjithë pensionistët e anketuar realizojnë beneficione pensionale në bazë të sigurimit publik pensional dhe rreth 90.5% prej tyre gëzojnë edhe të ardhura pensionale në bazë të shtyllës së dytë. Në rastin konkret, duke e patur parasysh modelin Gjerman të sigurimit pensional, duhet theksuar se ndoshta në mesin e pensionistëve të anketuar është paraqitur keqkuptim meqë që të gjithë e kanë të qartë se në këtë shtet kontributet paguhen në mënyrë të ndarë nga kompanija dhe nga paga e të punësuarve në proporcion 50%-50%. Siç mundet të vërehet rreth 95% nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë deklaruar se nuk realizojnë beneficione


pensionale në bazë të shtyllës së tretë që dëshmon se shumë pak kanë patur gadishmëri të investojnë vullnetarisht në shtyllën e tretë të sigurimit pensional.

Graf.4.6. Mosha e pensionimit në Gjermani



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikonin e mëlartëm, pjesa dërmuese e pensionistëve të anketuar janë pensionuar në moshën e rregullt të paraparë si për meshkujt ashtu edhe për femrat në Gjermani, pra atë 65 vjeçare. Në fakt 77%, respektivisht 197 nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar janë pensionuar në moshë të rregullt. Siç është theksuar edhe më herët, sistemi pensional Gjerman lejon edhe pensionim të parakohëshëm edhe pensionim të mëvonëshëm me qëllim të sigurimit të benefiteve më të larta pensionale. Kështu 49 ose afro $\frac{1}{4}$ nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë shfrytëzuar të drejtën e pensionimit të parakohëshëm dhe vetëm 9 ose rreth 4% kanë vazhduar të jenë aktiv edhe pas moshës 65 vjeçare pra kanë realizuar pensionimin e vonuar.


Graf.4.7. Shkalla e satisfacionit me pensionin



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, studimi i kryer në tërësi i vërteton edhe pritjet gjenerale kur bëhet fjalë për shkallën e satisfakcionit të pensionistëve me lartësinë e pensioneve të tyre. Kjo komfirmohet me vetë faktin se nga gjithsej 255 pensionistë të anketuar, 214 respektivisht 84% kanë theksuar se janë shumë të kënaqur me pensionin e tyre dhe 35 ose 14% sosh kanë deklaruar se janë pjesërishtë të kënaqur me pensionin e tyre. Vetëm 6 pensionistë të anketuar janë deklaruar si të pakënaqur nga lartësija e pensionit të tyre.

Në grafikun e mëposhtëm vijojnë të dhëna mbi perceptimin që kanë pensionistët e kyçur në anketim për pensionin e tyre, graf.4.8.


Graf.4.8. Peceptimet e të anketuarve mbi pensionet e tyre



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, pensionistët e anketuar kanë qëndrim pozitiv mbi pensionet e tyre. Kjo dëshmohet me vetë faktin se:


- 99.6% nga numri i përgjithëshëm i të anketuarve kanë deklaruar se pensioni që pranojnë u mjafton për plotësimin e nevojave ditore.
- Asnjë i anketuar nuk ka deklaruar se pensioni i tij nuk është i rregullt.
- Rreth 65% nga numri i përgjithëshëm i të anketuarve vlerësojnë se pensioni i tyre u mundëson jetë luksoze.
- Vetëm një i anketuar ose 0.3% ka deklaruar se pensioni është i pasigurt dhe i keq.
- Mbi 94% nga numri i përgjithëshëm i të anketuarve pensionin e tyre e vlerësojnë si të lartë dhe
- Vetëm afro 2% nga numri i përgjithëshëm i të anketuarve pensionin e tyre e konsiderojnë si të pamjaftueshëm.

Graf.4.9. Rregullshmëria e pensioneve



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, pensionistët e anketuar vlerësojnë se pensionet e tyre janë të rregullta. Kështu, vetëm 16 të anketuar, e vlerësojnë pensionin e tyre si jo të rregullt.


Graf.4.10. Informimi i të anketuarve mbi ekzistimin e marrëveshjes bilaterale



Siç mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm hulumtimi nxjerr në pah një shkallë të lartë të informimit të pensionistëve të anketuar me ekzistimin e marrëveshjes bilaterale në mes


Maqedonisë dhe Gjermanisë në fushën e sigurimit social. Kështu 221 ose 86.6% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë deklaruar se janë të vetëdijshme se ekziston një marrëveshje e kësaj natyre dhe vetëm 34 ose më pak se 14% nga to kanë deklaruar se nuk e dinë që ekziston një marrëveshje e kësaj natyre. Megjithatë, rezultatet janë shumë më ndryshe kur bëhet fjalë për shkallën e informimit të pensionistëve të anketuar me përmbajtjen e kësaj marrëveshje në fushën e pensioneve.

Graf.4.11. Informimi i të anketuarve mbi përmbajtjen e marrëveshjes bilaterale




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm edhe pranë faktit që e dinë se ekziston marrëveshje bilaterale në mes Gjermanisë dhe Maqedonisë në fushën e sigurimit pensional, shumë pak pensionistë e kanë lexuar të njëjtën. Kështu vetëm 6 ose diç më shumë se 2% nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë deklaruar se e kanë lexuar marrëveshjen bilaterale në mes dy vendeve.

Graf.4.12. Informimi i të anketuarve mbi të drejtat dhe obligimet e tyre



Edhe pranë faktit që nuk e kanë lexuar marrëveshjen bilaterale në mes Maqedonisë dhe Gjermanisë, afro 95% nga numri i përgjithshëm i pensionistëve të anketuar kanë deklaruar se janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe obligimet e tyre.

Graf.4.13. Përkrahja financiare e pensionistëve për familjarët e tyre



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, pensionistët e anketuar luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionalitetit ekonomik të shoqërisë në vend përmes shfrytëzimit të ardhurave nga pensioni i tyre për të ofruar ndihmë financiare

për familjarët e tyre në vend. Kjo dëshmohet me vetë faktin se made 198 ose 77.6% nga numri i përgjithëshëm i të anketuarve kanë deklaruar se të ardhurat nga benefitet e tyre pensionale i shfrytëzojnë për të përkrahur financiarisht familjarët e tyre.

3. Komentim i rezultateve kundrejt hipotezave

Punimi i magistraturës ka synuar testimin e një hipoteze bazë dhe tre hipotezave ndihmëse.

Hipoteza bazë është përkufizuar me sa vijon: “Sigurimi pensional i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut me punësim të përkohëshëm në Gjermani realizohet komfor standardeve ndërkombëtare dhe marëveshjes së nënshkruar mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë”.

Të dhënat statistikore si dhe rrjedha e deritanishme e pagesës së beneficioneve poensionale për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut që gëzojnë pension Gjerman, dëshmon qartë se Marëveshja bilateral në mes dy shteteve dhe e cila është në tërësi e përputhur me standardet dhe marëveshjet ndërkombëtare në këtë lëmi, janë të respektuara plotësisht. Pensionet nuk shënojnë aspak vonesa. Tërsija e tekstit të përmbajtur në suaza të kreut të tretë të disertacionit të magistraturës qartë vërteton hipotezën bazë të disertacionit, përkatësisht se Sigurimi pensional i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut me punësim të përkohëshëm në Gjermani realizohet komfor standardeve ndërkombëtare dhe marëveshjes së nënshkruar mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë.

Hipoteza e parë ndihmëse e disertacionit të magistraturës është përcaktuar me sa vijon: “Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, përkohësisht të punësuar në Gjermani, janë mirë të informuar për të drejtat dhe obligimet e tyre që sanksionohen me marëveshjen bilaterale në sferën e sigurimit pensional”. Kjo hipotezë gjithashtu është e vërtetuar në tërësi komfor të dhënave të paraqitura në suaza të grafikonëve 4.10 dhe 4.12 të disertacionit e të cilët qartë dëshmojnë se të anketuarit janë të informuar për ekzistimin e marëveshjes bilaterale në mes dy

vendeve dhe se ato janë të vetëdijëshëm për obligimet dhe të drejtat që kanë si përfitues të sigurimit pensional Gjerman.

Hipoteza e dytë ndihmëse e disertacionit të magistraturës “Transferimi i të drejtave pensionale nga Gjermania në Maqedoninë e Veriut është cilësorë dhe nuk shkaktohen pengesa për qytetarët e Maqedonisë së Veriut” gjithashtu është vërtetuar duke patur parasysh rezultatet e paraqitura në suaza të grafikoneve 4.7 përmes të cilit dëshmohet një shkallë e lartë e satisfakcionit të pensionistëve të anketuar me pensionet e tyre, grafikoni 4.8 nga i cili qartë vërehet se që të gjithë pensionistët e anketuar deklarojnë se e marrin pensionin në mënyrë të rregullt, grafikoni 4.9 nga i cili qartë dëshmohet se 94% i pensionistëve të anketuar dëshmojnë se nuk kanë vonesa në pranimin e pensionit të tyre.

Hipoteza e tretë ndihmëse e disertacionit të magistraturës “Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, që janë shfrytëzues të pensionit Gjerman, kontribuojnë në përmirësimin e standardit jetësorë në vend përmes ofrimit të përkrahjes financiare për familjarët e tyre” gjithashtu është vërtetuar. Kështu, nga të dhënat e paraqitura në grafikonin 4.13 qartë vërehet se mbi $\frac{3}{4}$ nga numri i përgjithëshëm i pensionistëve të anketuar kanë deklaruar se e shfrytëzojnë pensionin e tyre që të ofrojnë përkrahje financiare për familjarët e tyre.

Përfundime dhe rekomandime

Disertacioni i magistraturës në përmbajtjen e tij teorike dhe empirike qartë dëshmon rëndësinë e marrëveshjeve bilaterale në mes Maqedonisë së Veriut dhe Gjermanisë në fushën e sigurimit pensionale, e që përfshin edhe çështjen e sigurimit pensional, është me një rëndësi të veçantë. Kjo në veçanti duke patur parasysh numrin e madh të diasporës me punësim të përkohëshëm në Gjermani si një nga destinacionet më atraktive për mërgimtarët tonë ndër decaenue me rradhë.

Studimi i kryer me 255 persona që gëzojnë beneficione pensionale Gjermane, por që pas pensionimit janë kthyer në Maqedoni, mundëson ardhjen në disa përfundime bazë edhe atë:

- Në mesin e pensionistëve tonë të kthyer nga Gjermania, shumë pak janë prezente raste të pensionistëve që kanë siguruar beneficione pensionale nga shtylla e tretë e sigurimit pensional në Gjermani, përkatësisht nga siguri mi vullnetar. Por, nga ana tjetër të gjithë pensionistët e anketuar realizojnë beneficione pensionale në bazë të sigurimit publik pensional dhe të ardhura pensionale në bazë të shtyllës së dytë.
- Pjesa dërmuese e pensionistëve të anketuar janë pensionuar në moshën e rregullt të paraparë si për meshkujt ashtu edhe për femrat në Gjermani.
- Pensionistët janë shumë të kënaqur me lartësinë e pensionit të tyre.
- Pensionistët e anketuar kanë qëndrim pozitiv mbi pensionet e tyre.
- Pensionistët e anketuar vlerësojnë se pensionet e tyre janë të rregullta.
- Hulumtimi nxjerr në pah një shkallë të lartë të informimit të pensionistëve të anketuar me ekzistimin e marrëveshjes bilaterale në mes Maqedonisë dhe Gjermanisë në fushën e sigurimit social. Por edhe pranë faktit që e dijnë se ekziston marrëveshje bilaterale në mes Gjermanisë dhe Maqedonisë në fushën e sigurimit pensional, shumë pak pensionistë e kanë lexuar të njejtën.
- Pensionistë e anketuar janë shumë të vetëdijëshëm për të drejtat dhe obligimet e tyre.

- Pensionistët e anketuar luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionalitetit ekonomik të shoqërisë në vend përmes shfrytëzimit të ardhurave nga pensioni i tyre për të ofruar ndihmë financiare për familjarët e tyre në vend

Bibliografia

- Andras Simonovits: **Modeling Pension Systems**, Palgrave Macmillan, 2003
- Antoine Bozio: *“Impact Evaluation of the 1993 French pension reform in retirement age”*, **Pensions: An International Journal**, Volume 13, Issue 4,
- Axel H. Borsch-Supan, Christina B. Eilke: **The German Public Pensions System: Hoë it Eäs, Hoë it eill be**, Michigan Retirement Research Center, 2003
- Birgit Mattil: **Pension Systems: Sustainability and Distributional Effects in Germany and the United Kingdom**, Physica Verlag, 2006
- Camila Arza, Martin Kohli: *“The Political Economy of Pension Reform”*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008
- Cindy Duc, Henri Martin, Julie Treguier: **The pension reforms from 2010 to 2015 in France: A detailed analysis of the impact for policyholders and for pension schemes**, Sommaire: Les Dossiers De La Drees, December, 2016, No.9
- David Natali, Martin Rhodes: *“The Neë Politics of Pension Reforms in Continental Europe”*, Camila Arza (Ed), Martin Kohli (Ed): **Pension Reform in Europe: Politics, Policies and Outcomes**, Routledge / Taylor & Francis Group, 2008
- Francois Jeger, MicheleLelievre: *“The French pension system and 2003 reform”*, **The Japanese Journal of Social Security Policy**, Vol.4, No.2,
- J.B. Kune: *“Solidarities in Colective Pension Schemes”*, Onno Steenbeek (Ed), Fieke van der Lecq: **Costs and benefits of Collective Pension Systems**, Springer, 2007
- Jillian Jimenez, Eyleen majers Pasztor, Ruth M. Chambers, Cheryl Pearlman Fujii: **Social Policy and Social Change: Toëard the Creation of Social and Economic Justice, Second edition**, SAGE Publishing, 2015
- Jochen Clasen: *Social Policy in Europe*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon Eright (Ed): **The Student’s Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John Eiley & Sons, Ltd, 2012

- John Besears, James J. Choi, David Laibson, Brigitte C. Madrian: *“The Importance of Default Options for Retirement Saving Outcomes: Evidence from the USA”*, Stephen J. Kay (Ed), Tapen Sinha (Ed): **Lessons from Pension Reform in the Americas**, Oxford University Press, 2008
- Ken Blakemore, Edëin Griggs: **Social Policy: An Introduction, Third edition**, Open University Press, 2007
- Klaus Stieffermann: *“The never-ending story of German pension reform”*, IPE, 2004
- Leszek Kasek, Thomas Laursen, Emilia Skrok: *“Sustainability of Pension Systems in the Neë EU Member States and Croatia: Coping ëith Aging Challenges and Fiscal Pressures”*, **ëorld Bank ëorking Paper, No.129**, 2008
- Maria Verena Bronbacher Steiner: *“The Sëiss Three-Pillar Model”*, Axel H. Barsch-Supan (Ed), Meinhard Miegel (Ed): **Pension Reform in Six Countries: ëhat Can ëe Learn From Each Other**, Springer-Verlag, 2001
- Michael Hill: *Social Policy in Liberal Market Societies*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon ëright (Ed): **The Student’s Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John ëiley & Sons, Ltd, 2012,
- Paul Spicker: **Social Policy: Theory and Practice, Third edition**, Policy Press, 2014
- Pete Alcock: **Social Policy in Britain: Themes and Issues**, Macmillan Press Ltd, 1996
- Pete Alcock: *The Subject of Social Policy*, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon ëright (Ed): **The Student’s Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John ëiley & Sons, Ltd, 2012
- Peter R. Orszag, Joseph Stiglitz: *“Rethinking Pension Reform: 10 Myths About Social Secutiry Systems”*, Robert Holzmann (Ed), Joseph E. Stiglitz (Ed): **Neë Ideas About Old Age Security: Toëard Sustainable Pension Systems in the XXI Century**, The International Bank for Reconstruction and Development/ëorld bank, 2001
- Rana Jaëad: **Social Policy in Middle-Eastern Societies**, Pete Alcock (Ed), Margaret May (Ed), Sharon ëright (Ed): **The Student’s Companion to Social Policy, Fourth Edition**, John ëiley & Sons, Ltd, 2012
- Richard M. Titmuss: **Essays on “The ëelfare State”**, Ruskin House, 1959

Shtojcë